



**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë**  
**Departamenti i të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit**  
**Seksioni i monitorimit të sistemit juridik**

**KOSOVË**

**REAGIMI I SISTEMIT JURIDIK NDAJ TRAZIRAVE TË  
MARSIT 2004**

**DHJETOR 2005**

## INDEKSI

<b>INDEKSI</b> .....	<b>2</b>
<b>SHKURTESAT</b> .....	<b>3</b>
<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b> .....	<b>4</b>
<b>KAPITULLI I PARË</b> .....	<b>5</b>
HYRJE .....	5
<i>Mandati i SMSJ-së</i> .....	5
<i>Historiku i trazirave të marsit 2004</i> .....	5
<i>Shtrirja e raportit</i> .....	6
<b>KAPITULLI I DYTË</b> .....	<b>8</b>
PROBLEMET ME MBLEDHJEN E DËSHMIVE DHE KOHËZGJATJEN E PROCEDURËS .....	8
1. <i>Problemi i frikësimit të mundshëm në rastet penale të ndërlidhura me trazirat</i> .....	8
1.1 Shembujt e mungesës së vullnetit të dëshmitarëve për të dhënë deklaratat e tyre.....	9
1.2 Shembujt e problemeve të ballafaquara gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së dëshmitarëve në procedurat e ndërlidhura me trazirat .....	11
1.3 Çështjet përkitazi me sigurinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve .....	12
2. <i>Çështjet që kanë të bëjnë me mbledhjen e dëshmive në rastet e trazirave</i> .....	13
2.1 Vështirësitë në marrjen e dëshmive si rrjedhojë e zhvendosjes për shkak të dhunës .....	13
2.2 Vështirësitë në marrjen e dëshmive si rezultat i personave që përfundojnë misionin .....	14
2.3 Vështirësitë në marrjen e dëshmive si rrjedhojë e mos paraqitjes së dëshmitarit para gjykatës dhe mos ofrimi i materialit të kërkuar të provave .....	15
2.4 Çështjet tjera që kanë të bëjnë me mbledhjen e dëshmive .....	17
3. <i>Vonesat në rastet që ndërlidhen me trazirat</i> .....	18
4. <i>Rekomandimet</i> .....	21
<b>KAPITULLI I TRETË</b> .....	<b>23</b>
AKUZAT DHE DËNIMET .....	23
1. <i>Akuzat joadekuate</i> .....	23
2. <i>Pranimi i fajësisë dhe deklarimi i fajësisë me marrëveshje</i> .....	24
3. <i>Caktimi i denimeve</i> .....	28
3.1 Vrojtimet e përgjithshme –tendenca drejt zbutjes së denimeve .....	28
3.2 Rrethanat rënduese dhe lehtësuese të shqyrtuara nga gjykatat .....	29
3.2.1 Rrethanat rënduese .....	29
3.2.2 Rrethanat lehtësuese .....	31
3.2.3 Arsyetimi i pamjaftueshëm i dënimit të zbutur.....	33
4. <i>Rekomandimet</i> .....	34
<b>KAPITULLI I KATËRT</b> .....	<b>35</b>
PËRFUNDIM .....	35
<b>ANEKSET</b> .....	<b>36</b>
<b>ANEKSI 1. PASQYRA STATISTIKORE PËR RASTET E TRAZIRAVE</b> .....	<b>36</b>
<i>Në përgjithësi</i> .....	36
<i>Rajoni i Prishtinës/Priştina</i> .....	36
<i>Rajoni i Gjilanit/Gnjilane</i> .....	36
<i>Rajoni i Prizrenit</i> .....	37
<i>Rajoni i Pejës/Peć</i> .....	37
<i>Rajoni i Mitrovicës/Mitrovica</i> .....	37

## SHKURTESAT

DAGj	Departamenti i administratës gjyqësore
DD	Departamenti i drejtësisë
KEDNJ	Konventa evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut
GJEDNJ	Gjykata evropiane e të drejtave të njeriut
RFJ	Republika Federale e Jugosllavisë
LP i RFJ-së	Ligji penal i Republikës Federale të Jugosllavisë
LPP i RFJ-së	Ligji i procedurës penale i Republikës Federale të Jugosllavisë
KFOR	Forca e Kosovës
IGJK	Instituti Gjyqësor i Kosovës
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
LPK	Ligji penal i Kosovës
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
SMSJ	Seksioni i monitorimit të sistemit juridik
OMiK	Misioni i OSBE-së në Kosovë
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
KPPK	Kodi i përkohshëm penal i Kosovës
KPPPK	Kodi i përkohshëm i procedurës penale të Kosovës
SPU	Njësi i policisë speciale
PSSP	Përfaqësuesi special i sekretarit të përgjithshëm
KB	Kombet e Bashkuara
UNHCR	Komesariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UNMIK	Misioni i administratës së përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
NMD	Njësi për mbrojtjen e dëshmitarëve

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ndërmjet 17 dhe 19 marsit 2004 një valë e trazirave u përhap në tërë Kosovën me pasoja të mëdha për marrëdhëniet edhe ashtu të tensionuara në rajon. Përderisa efektet politike të trazirave janë shqyrtuar në mënyrë të hollësishme në raportet tjera, ky raport përqëndrohet në mënyrën se si sistemi i drejtësisë është marrë me rastet penale që kanë lindur nga trazirat e Marsit 2004. Pasiqë përgjigja e sistemit të drejtësisë ndaj veprave penale është me rëndësi kruciale në cilëndo shoqëri ku sundimi i ligjit mbizotëron, në rastet e veçanta që kanë buruar nga trazirat e marsit ky nivel i përgjegjës në anën e autoriteteve të prokurorisë dhe gjyqësisë së Kosovës bartë mbi vete një peshë më të rëndë, duke pasur parasysh rëndësinë e saj për të ardhmen në Kosovë ku krimet ndëshkohen dhe bashkësitë e ndryshme janë në gjendje të bashketojnë dhe të rregullojnë problemet e tyre nëpërmjet shfrytëzimit efektiv të sistemit gjyqësor.

Pas monitorimit të rasteve që ndërlidhen me veprat penale të kryera gjatë trazirave të Marsit 2004, OSBE-ja ka vërtetuar se ka pasur probleme të numërta që kanë ndikuar në hetimet penale. Këto probleme janë përshkruar në kapitullin e dytë të këtij raporti. Në përgjithësi, OSBE-ja ka vërejtur se ekzistojnë vështirësi në mbledhjen e dëshmive, që rezultojnë nga një numër i faktorëve, përfshirë këtu edhe frikësimin e dëshmitarëve, mungesën e vullnetit të dëshmitarëve për të dëshmuar para gjyqit, zhvendosjen e palëve të dëmtuara të cilat nuk kanë pjesëmarrje në procedurat gjyqësore dhe humbjen e dëshmive materiale. Vështirësitë në mbledhjen e dëshmive kanë rezultuar në vonesa në gjykimin e shumë rasteve të trazirave, që janë rënduar edhe më shumë nga bashkëpunimi i dobët ndërmjet të policisë dhe prokurorisë që kanë zhvilluar hetimet si dhe numrin e vogël të rasteve në gjykata dhe dënimeve në krahasim me numrin e madh të pjesëmarrësve në trazira dhe shkallën e ngjarjeve që kanë ndodhur në tërë Kosovën në mars të vitit 2004.

Përpos problemeve në mbledhjen e dëshmive dhe zhvillimin e hetimeve efektive dhe me kohë, mënyra me të cilën gjykatat janë marrë me rastet e trazirave ngrit shqetësime në lidhje me praktikën e ngritjes së akuzave dhe ato të shqiptimit të dënimeve që janë përdorur nga gjykatat. Kapitulli tre i këtij raporti përqëndrohet në këto çështje duke analizuar problemet e ngritjes së akuzave joadekuate që nuk korespondojnë me faktet e rastit dhe përdorimi jo i duhur i marrëveshjeve për deklarimin e fajësisë të negociuara ndërmjet gjyqtarëve dhe/apo ndjekjes penale dhe palës mbrojtëse pa ndonjë bazë të qartë për këtë. Këto praktika kanë rezultuar në dënime të lehta të shqiptuara nga ana e gjykatave në shumicën e rasteve me tendencë të butësisë gjatë shqiptimit të dënimeve duke shqiptuar dënime minimale apo edhe dënime që bijnë në minimumin e paraparë me ligj kundër të akuzuarve. OSBE-ja gjithashtu ka vërejtur një shfrytëzim jo të duhur të rrethanave lehtësuese dhe rënduese në vendimet që nuk përmbajnë arsyetim të duhur.

Pjesa e fundit e raportit ofron një pasqyrë statistikore të rasteve të ndërlidhura me trazirat. Që nga 18 nëntori 2005, nga 426 persona të akuzuar për vepra penale që ndërlidhen me trazirat, 209 persona janë dënuar përderisa 12 prej tyre janë liruar nga akuzat. Ekzistojnë 110 raste të cilat ende janë në zhvillim e sipër pranë gjykatës dhe akuzat janë tërhequr në 95 raste.

Në përgjithësi duke marrë parasysh pasojat e trazirave të marsit të vitit 2004 në aspektin e humbjeve të jetërave, dëmtimit të pasurisë dhe zhvendosjes së pakicave, OSBE-ja është e mendimit se edhe pse sistemi ligjor i ka adresuar këto raste, përgjigja nuk ka qenë mjaft e fuqishme. Sistemi ligjor ka dështuar të dërgojë porosi të qartë popullatës për dënimin e këtij lloji të dhunës. Një përgjigje e këtillë nuk shërben si e e mjaftueshme për të parandaluar përfshirjen në prishjen e rendit publik në shkallë të gjerë dhe së këndejmi nuk përmbush funksionin parandalues që e ka sistemi i drejtësisë.

## KAPITULLI I PARË

### HYRJE

Ky raport është përgatitur nga Seksioni për Monitorimin e Sistemit Ligjor (SMSJ), që është pjesë e Departamentit për të Drejtat e Njeriut dhe Sundimit të Ligjit (më tutje departamenti) i Misionit të OSBE-së në Kosovë (më tutje OSBE-ja). OSBE-ja funksionon nën ombrellën e Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) si shtyllë për ndërtimin e institucioneve.

#### Mandati i SMSJ-së

Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 e ka autorizuar Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara që të themelojë një prani civile ndërkombëtare në Kosovë e cila do të ofrojë një administratë të përkohshme. Një nga përgjegjësitë e pranisë ndërkombëtare është edhe “*mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut.*”<sup>1</sup>

Sipas raportit të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara të 12 korrikut 1999, roli i ndërtimit të institucioneve në kuadër të UNMIK-ut i është caktuar OSBE-së me një nga detyrat e shtyllës për ndërtimin e institucioneve që është monitorimi për të drejtat e njeriut. Raporti udhëzon në mënyrë shprehimore UNMIK-un që të zhvillojë mekanizma të koordinuar për të lehtësuar monitorimin e të drejtave të njeriut dhe funksionimin e duhur të sistemit gjyqësor.<sup>2</sup>

Një letër e marrëveshjes, e datës 19 korrik 1999, ndërmjet Nënsekretarit të Përgjithshëm të Operacioneve Paqëruajtëse të Kombeve të Bashkuara dhe Përfaqësuesit të Kryesuesit të Radhës së OSBE-së theksuan se OSBE-ja duhet të zhvillojë mekanizma për të siguruar që gjykatat, tribunalët administrative dhe strukturat tjera gjyqësore veprojnë në pajtim me standardet ndërkombëtare të drejtësisë penale dhe të drejtave të njeriut.<sup>3</sup> Në kuadër të OSBE-së, departamenti ka përgjegjësi të monitorojë dhe raportojë për sistemin gjyqësor në aspektin e të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit. Në kuadër të departamentit, SMSJ-ja ka për detyrë të monitorojë rastet e sistemit të drejtësisë, duke vlerësuar pajtueshmërinë e tyre me standardet ndërkombëtare dhe raportimin mbi çështjet që paraqesin shqetësim.

#### Historiku i trazirave të marsit 2004

Në mars të vitit 2004, një numër i protestave,<sup>4</sup> dhe akteve të mosbindjes civile<sup>5</sup> që ndodhën në Kosovë. Ndërmjet 17 dhe 19 marsit të secilit vit, gjendja u kthye në mënyrë dramatike për të keq, si valë e trazirave që pushtuan tërë Kosovën.

<sup>1</sup> Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, 12 qershor 1999, paragrafi 11/j.

<sup>2</sup> Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, *mbi Administratën e Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë*, S/1999/779, 12 korrik 1999, para. 87.

<sup>3</sup> Qarkorja e drejtësisë 2001/15 *OSBE-ja monitoron qasjen në procedurat gjyqësore dhe dokumentet gjyqësore*, 6 qershor 2001, rivërtetoi se monitoruesit e gjykimeve të SMSJ-së kanë qasje në të gjitha procedurat dhe dokumentet gjyqësore, me disa përjashtime. Kjo është ndryshuar me Qarkoren e Drejtësisë 2004/6, 30 shtator 2004, e cila ka konstatuar se SMSJ-ja gjithashtu ka qasje në procedurat gjyqësore dhe administrative dhe dokumentet e gjykatës në pajtim me një marrëveshje të arritur ndërmjet të policisë dhe shtyllës së drejtësisë së UNMIK-ut dhe OSBE-së. Kjo qarkore ka për qëllim të shtojë kuptimin e gjyqësisë për mandatin e OSBE-së dhe të sigurojë që monitoruesit e OSBE-së të gjykimeve mbulojnë në mënyrë të plotë procedurat penale, civile dhe administrative.

<sup>4</sup> Më 5 mars 2004, dialogu ndërmjet Prishtinës/Priştina dhe Beogradit mbi çështje teknike për planin e implementimit të standardeve për Kosovën ishte pasuar me protesta në Prishtinë/Priştina. Më 16 mars 2004 një tubim paqësor ishte mbajtur në qendër të qytetit të Prishtinës/Priştina për të protestuar kundër

Këto trazira duket të jenë shkrepur nga ngjarjet e ditës së mëparshme. Më 16 mars, tre djem shqiptarë ishin përmytur në lumin Ibër, afër Çabrës/Čabra, në komunën e Zubin Potokut. Mediat raportuan se djali i katërt i cili kishte qenë me ta dhe kishte mbijetuar pohoi se katër djemtë ishin ndjekur për në lum nga serbët e fshatit fqj me një qen. Në natën e 16 marsit, mediat kosovare raportuan për zhdukjen dhe supozuan përmytjen e tre djemve. Përkundër apeleve për kujdes nga policia e UNMIK-ut, televizionet raportuan shpejtë dhe fuqimisht i atribuuan vdekjet e djelmohave sulmit të bërë nga serbët duke i dhënë këtij incidenti një potencial të menjëhershëm për të shtuar tensionet në marrëdhëniet ndëretnike në Mitrovicë/Mitrovica dhe vendet tjera anembanë Kosovës.<sup>6</sup>

Më 17 mars protestat për këto vdekje filluan në Mitrovicë/Mitrovica dhe shumë shpejtë eskaluan në një konflikt ndëretnik ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës afër urës së lumit Ibër e cila lidh pjesët e ndara veriore dhe jugore të qytetit. Kah fundi i ditës, protestat e ndërlydhura në secilin qytet të madh të Kosovës u transformuan në trazira të dhunshme kundër pjesëtarëve të pakicave, organeve për zbatimin e ligjit dhe forcave të sigurisë.

Sipas raporteve të policisë së UNMIK-ut, 33 trazira të mëdha ishin numëruar, ku vlerësohej se rreth persona 51,000 kishin qenë të përfshirë.<sup>7</sup> Personat e përfshirë në këto trazira ishin të moshave të ndryshme dhe stutuseve të ndryshme shoqërore. Megjithatë, shumica e atyre që ishin akuzuar për vepra penale ishin të rinjë, kryesisht të papunësuar dhe me arsimim të ulët. Në shumicën e rasteve, mosha e personave të akuzuar për vepra penale të kryera gjatë trazirave sillej prej 18 në 19 vjet, ku më i vjetri ishte i moshës 77 vjeçare dhe më i riu i moshës 15 vjeçare; për më tepër, arsimimi i tyre sillet nga ata analfabet deri te ata, në vetëm disa raste me arsimim të lartë.<sup>8</sup>

## Shtrirja e raportit

---

arrestimit të një ish komandanti të UÇK-së Fatmir Limaj. Protestat e ngjashme ishin mbajtur në Mitrovicë/Mitrovica, Pejë/Peć, Prizren dhe gjetiu.

<sup>5</sup> Më 15 mars 2004, si përgjigje ndaj dekretit të UNMIK-ut mbi doganat që zhvlehtësoi ish ligjin jugosllav mbi doganat, grupe të serbëve të Kosovës kishin bllokuar dy vendkalime administrative me Sërbinë afër Zubin Potokut dhe Leposaviqit/Leposavić. Dita e ardhshme në një përgjigje ndaj një sulmi me armë në Caglavica/Čaglavica që rezultoi me lëndimin e një studenti serbt të Kosovës, magjistralet Prishtinë/Priština-Gjilan/Gnjilane dhe Prishtinë/Priština-Shkup ishin bllokuar në Graçanicë/Gračanica dhe Caglavica/Čaglavica nga banorët serbë të Kosovës të këtyre enklavave.

<sup>6</sup> Neni 2.2 i Kodit të Mirësjelljes për Mediat Transmetuese i Komisionerit të Përkohshëm të Mediave thekson se “Emetuesit nuk do të transmetojnë asnjë material që nxitë krim ose aktivitete kriminale, ose që përmbanë në vehte rrezikun e shkaktimit të dëmit, që mund të jetë vdekje, lëndim, dëmtim i pronës apo ndonjë formë tjetër e dhunës”. Në raportin e *komisionerit të përkohshëm të mediave: Hulumtim mbi rezultatit e punës së televizioneve gjithëkombëtare*, 16-17 mars 2004, 23 prill 2004, komisioneri i përkohshëm i mediave deklaroi se “gazetaria e matur, qetë dhe saktë ka mundur t’ju mohoi elementeve të organizuara pretextin për t’u ngritur në trazira, plaçkitur dhe djegur dhe ka mundur të zvogëloi shkallën dhe intensitetin e dhunës e cila ka ndodhur.” Do të duhej të përmendet se ky rast është hetuar nga prokurori ndërkombëtar me ndihmën e policisë. Megjithatë, për shkak të mungesës së dëshmive të mjaftueshme për ti plotësuar këto pretendime, prokurori ndërkombëtar vendosi që mos të kërkoj fillim e hetimeve gjyqësore.

<sup>7</sup> V.I.P. Raporti i lajmeve ditore, 23 mars 2004 “Zëdhënësi i policisë së UNMIK-ut [...] theksoi se policia supozoi se diku rreth 51,000 njerëz ishin përfshirë në 33 trazira.” Gjithashtu *shih Kolapsi në Kosovë – Raporti i Grupit Ndërkombëtar të Krizave (GNK) të Evropës* No. 155, 22 prill 2004, faqe 15.

<sup>8</sup> Kjo informatë bazohet në shqyrtimin e shënimeve personale të më shumë se 120 dokumenteve të gjykatave (aktakuzave, aktvendimeve, etj.).

Raporti i tanishëm merret kryesisht me rastet penale dhe kundërvajtjet,<sup>9</sup> të cilat kanë lindur nga trazirat e marsit 2004 dhe të cilat kanë përfunduar deri në fund të nëntorit 2005.<sup>10</sup> Kjo përqëndrohet në problemet e caktuara që ishin vërejtur sa i përket mbledhjes dhe qasjes në dëshmi mbi çështjet që kanë të bëjnë me mungesën e vullnetit të dëshmitarëve për të ofuar dëshmi dhe frikësimin e tyre të mundshëm si dhe vonesat në procesimin e rasteve të ndërlidhura me trazirat. Për më tepër, ky raport ofron një analizë të praktikave të caktuara të ngritjes së akuzave dhe shqiptimit të dënimeve. Në fund pasqyra statistikore e rasteve të ndërlidhura me trazirat për gjykatë në rajonet gjegjëse është paraqitur në shtojcën e këtij raporti. Këto statistika janë të bazuara në shënimet e OSBE-së dhe ato nuk paraqesin statistika zyrtare për rastet e ndërlidhura me trazirat.

Duhet të ceket se informatat e ofruara në këtë raport janë mbledhur kryesisht nëpërmjet të monitorimit të OSBE-së të procedurave penale të mbajtura në gjykatat për kundërvajtje, komunale dhe të qarkut anembanë Kosovës. Krahas kësaj, disa nga informatat e përmbajtura në këtë raport janë mbledhur gjithashtu nëpërmjet të intervistave me hetuesit e policisë dhe bisedat e mbajtura ndërmjet OSBE-së dhe gjyqtarëve dhe prokurorëve.

---

<sup>9</sup> Për qëllime të këtij raporti rastet penale duhet të kuptohet si diçka që prfshin akuzat në bazë të KPPK dhe/apo KP të RFJ-së apo KPK dhe ndjekja e procedurës së përcaktuar me KPPK. Rastet e kundërvajtjeve përfshijnë veprat e kualifikuara si kundërvajtje në bazë të ligjit (p.sh neni 18 i Ligjit mbi Rendin dhe Qetësinë Publike, *Gazeta zyrtare e KSA të Kosovës*, Nr. 13/81) dhe ndjekja e procedurës së përcaktuar me Ligjin për Kundërvajtje (*Gazeta zyrtare e KSA të Kosovës*, Nr. 23/79).

<sup>10</sup> OSBE-ja ka vërejtur se një numër i rasteve të ndërlidhura me trazirat janë pranuar nga gjykatat civile, mirëpo adresimi i lëndëve civile nga gjykatat civile nuk është shtjelluar në këtë raport.

## KAPITULLI I DYTË

### PROBLEMET ME MBLEDHJEN E DËSHMIVE DHE KOHËZGJATJEN E PROCEDURËS

Duke marrë parasysh kontrastet ndërmjet të numrit të vlerësuar të personave të përfshirë në trazirat e marsit (përafërsisht 51,000<sup>11</sup>) dhe numrit të personave kundër të cilave gjykatat kanë ngritur akuza për vepra penale të ndërlidhura me trazirat, i cili sipas dijenisë së OSBE-së, është 426 persona, mundet shumë lehtë të thuhet se në të vërtetë një përqindje e vogël e personave të përfshirë në trazira janë ndjekur penalisht. Ky kapitull nënvizon problemet e caktuara të cilat janë vrojtuar gjatë këtyre procedurave.<sup>12</sup>

Pikësëpari, hetimet janë penguar nga fakti se një numër i madh i dëshmitarëve nuk ishin të vullnetit që të vijnë në gjyq dhe të dëshmojnë apo ishin paraqitur para organeve hetimore mirëpo kishin dhënë deklarata kundërshtuese. Së dyti, në shumë raste palët e dëmtuara nuk kanë marrë pjesë në mënyrë efikase në procedurën penale. Së treti, një numër i deklarave të dëshmitarëve nuk ishin siguruar për qëllime të ndjekjes penale. Edhe pse rrethanat e posaçme të krijuara pas trazirave kishin penguar deri në një shkallë mbledhjen e dëshmive të rëndësishme, gjithashtu duket se organet hetimore nuk kanë qenë mjaft proaktive në sigurimin e deklarave të dëshmitarëve dhe të palëve të dëmtuara. Së fundi shumë raste të ndërlidhura me trazirat janë përballur me vonesa të konsiderueshme në fazat e ndryshme të procedurës.

#### 1. Problemi i frikësimit të mundshëm në rastet penale të ndërlidhura me trazirat

Derisa me mijëra ishin prezent në trazira, mijëra tjerë kanë pasur mundësi të shohin zhvillimin e ngjarjeve dhe kanë pasur mundësi të njohin kryesit e veprave penale, problemi qëndron në faktin se përkundër kësaj çka u tha më lartë nuk kishte dëshmitar të mjaftueshëm për ndjekjen penale të këtyre rasteve.<sup>13</sup> Arsytet për mungesën e vullnetit për t'ju ndihmuar organeve në hetimin e veprave penale të ndërlidhura me trazirat mund të sillen prej mungesës së ndjenjës qytetare e deri te simpatia kundrejt arsyeve për pjesëmarrësit e trazirave, e deri te frika nga frikësimi dhe ndëshkimi. OSBE-ja bën të ditur se është vështirë që të bëhet një vlerësim i qartë i arsyeve të posaçme në të gjitha rastet e ndërlidhura me trazirat ku ka pasur indikacione se dëshmitarët nuk ishin të vullnetit që të dëshmojnë apo shmangen dëshmive inkriminuese. Deri në këtë masë, nënseksioni si në vijim paraqet shembuj të caktuar të rasteve të monitoruara në të cilat OSBE-ja ka vërejtur shenja të mungesës së vullnetit të dëshmitarëve për të dhënë dëshmi inkriminuese kundër të pandehurve.

Frikësimi i dëshmitarëve në Kosovë ka ndikuar në një sërë procedurash penale në të kaluarën në Kosovë, veçanërisht atyre procedurave me natyrë të ndjeshme apo të profilit të lartë. Duke pasur shqetësime për këtë dukuri, OSBE-ja u ka kushtuar vëmendje problemeve të ndërlidhura me mbrojtjen e dëshmitarëve në sistemin e drejtësisë penale në Kosovë në raportet e kaluara publike.<sup>14</sup>

<sup>11</sup> Shih fusnotën si *më lartë* 7.

<sup>12</sup> Është me rëndësi të përmendet që më 6 prill 2004 legjislacioni i ri penal ka hyrë në fuqi dhe hetimet e nisura pas datës ishin zhvilluar sipas Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës. Gjithashtu rastet në të cilën aktakuza është ngritur pas 6 prillit 2004 i përmbahen regjimit të ri të procedurës penale. Lexo nenin 550 të KPPK-së në të *kundërtën*.

<sup>13</sup> Në bisedat me OSBE-në, hetuesit nga Operacioni Thor (njësia speciale e policisë formuan për të hetuar krimet e lidhura me trazirat e marsit 2004), prokurorët ndërkombëtar, dhe pjesëtarët e gjyqësisë kanë bërë me dije se është vështirë që të gjinden dëshmitarë që do të jenë të gatshëm të dëshmojnë në rastet penale që kanë ndodhur gjatë dhe pas këtyre ngjarjeve.

<sup>14</sup> Lexo në veçanti shqyrtimin e pestë të sistemit të drejtësisë penale të Misionit të OSBE-së në Kosovë me titull *Mbrojtja e dëshmitarëve në sistemin e drejtësisë penale* (mars 2002-prill 2003). Çështja është shtjelluar përsëri në shqyrtimin e gjashtë të sistemit të drejtësisë penale me titull *krimi, paraburgimi dhe dënimi* (dhjetor 2004), faqe 74 ff.



Në njohjen e faktit se frikësimi i palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve demotn seriozisht hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve serioze në Kosovë dhe përbën një pengesë të madhe për krijimin e sundimit të ligjit në Kosovë, ligji parashikon një sërë masash ligjore për mbrojtjen e palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve ashtuqë ata të kenë mundësi të marrin pjesë në procedurat gjegjëse pa u frikësuar apo pa rrezikim të sigurisë së tyre.<sup>15</sup>

Sa i përket rasteve të ndërlydhura me trazirat, përpos vëzhgimeve të bëra nga OSBE-ja gjatë aktiviteteve për monitorimin e gjykimit, shumë profesionistë në sistemin e drejtësisë i janë referuar frikësimit të dëshmitarëve si një nga problemet më të mëdha për hetimet dhe njëra nga më të vështirat për t'u përballuar. Në shumë raste të caktuara, është sugjeruar se madje edhe palët e dëmtuara të cilt janë pjesëtarë të grupeve minoritare nuk ishin të prirur që të dëshmojnë në gjyq kundër të dyshuarve për shkak se shumë palë të dëmtuara kanë shprehur qëllimin që të vazhdojnë të jetojnë në Kosovë dhe për shkak se ata frikoheshin për sigurinë e tyre në rast të inkriminimit të dyshuarve.

Në procedurat gjyqësore të inicuar për rastet e lidhura me dhunën e trazirave, masat për mbrojtjen e dëshmitarëve të bazuara në kodin e procedurës penale me të vërtetë ishin shfrytëzuar edhe pse në një numër të kufizuar të rasteve të profilit të lartë ku që të gjitha prej tyre ishin trajtuar nga prokurorët ndërkombëtar. Në bazë të shefit të njësisë për mbrojtjen e dëshmitarëve,<sup>16</sup> kjo njësi nuk ka qenë e përfshirë në mbrojtjen e dëshmitarëve në lidhje me rastet e trazirave në kuadër të periudhës raportuese.

### ***1.1 Shembujt e mungesës së vullnetit të dëshmitarëve për të dhënë deklaratat e tyre***

Në shembujt e mëposhtëm OSBE-ja ka vërejtur në dëshmitarë shenja të mungesës së vullnetit për të dhënë dëshmi të hapur dhe të menjëhershme në gjykatë dhe për të bashkëpunuar me organet hetimore. Çka është shqetësim më i madh është ajo se shumica e ketyre dëshmitarëve ishin zyrtarë policor.

Në një rast pranë Gjykatës së Qarkut në Pejë/Peć kundër një personi të akuzuar për udhëheqje të trazirave të 17 marsit 2004 në Deçan/Dečani, disa dëshmitarë janë intervistuar gjatë seancave hetimore, ku disa prej tyre ishin pjesëtar të SHPK-së vendëse dhe të tjerë nga rradhët e policisë ndërkombëtare. Disa nga këta dëshmitarë ishin në qendër të qytetit kur trazirat kishin ndodhur mirëpo përderisa të gjithë policët ndërkombëtar identifikuan të pandehurin si udhëheqës të turmës i cili duke folur me megafon i ishte drejtuar popullit që të shkatërroj pronën e KB-ve, shumë zyrtarë të SHPK-së deklaruan se i pandehuri nuk kishte nxitur trazirat dhe thjeshtë ai ishte

<sup>15</sup> Masat që janë paraparë në procedurën penale përfshijnë: heqjen apo shlyerja e emrave; moszbulimi i procesverbalit; përpjekjet për të fshehur veçoritë apo përshkrimin fizik; caktimi i pseuonimeve; seancat e mbyllura të procedurës gjyqësore për publikun; urdhërat për avokatin mbrojtës që të mos zbulojë identitetin e dëshmitarit; urdhërat për heqjen e përkohshme të të akuzuarit nga gjykatorja; anonimiteti. Lexo Rregulloren e UNMIK-ut 2001/20 për mbrojtjen e palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve në procedurën penale, i datës 19 shtator 2001 (siç është ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/1), siç është implementuar nëpërmjet të Urdhëresës Administrative 2002/25, datës 13 nëntor 2002. Kjo rregullore është zëvendësuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/26 mbi Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale (KPPPK), i datës 6 korrik 2003. KPPPK-ja rregullon sistemin e masave mbrojtëse të dëshmitarëve dhe palëve të dëmtuara në nenet e veta prej 168 deri 174. Për më tepër, në disa rrethana të veçanta mbrojtja fizike e dëshmitarëve mund të ofrohet nga ana e një njësie të specializuar të policisë të njohur si Njësia për Mbrojtjen e Dëshmitarëve (NjMD). Veprimet e këtij njësi përfshijnë ofrimin e strehimores së sigurtë në Kosovë derisa dëshmitari ta jap dëshminë dhe transferimin e dëshmitarit në një shtet tjetër pas gjykimit. NjMD-ja është themeluar në qershor 2001 nën autoritetin e komisionerit të policisë së UNMIK-ut për të themeluar dhe administruar programin për mbrojtjen e dëshmitarit (lexo memorandumun e datës 28 qershor 2001 nga komisioneri i policisë dërguar zëvendës komisionerit të policisë për operacione, administratë dhe planifikim dhe zhvillim që miraton themelimin e NjMD).

<sup>16</sup> Lexo fusnotën 15 si më lartë.

përpjekur që të qetësojë turmën. Ky dallim i qartë ndërmjet dëshmimit në gjykatë ndërmjet policëve vendës dhe ndërkombëtar, edhe pse të gjithë prej tyre kishin dëshmuar të njëjtat fakte, mirëpo si duket kanë parë gjëra të ndryshme, shton dyshimet përkitazi me vërtetësinë e deklaratave të oficerëve të policisë. Si rrjedhojë e këtyre dallimeve prokuroria nuk kishte qenë në gjendje të mbledh dëshmi të qëndrueshme për të mbështetur aktakuzën dhe për të përfunduar hetimet kundër të pandehurit.

Në vlerësimin e fakteve në shembullin e mësipërm, duhet të merret parasysh historiku i frikësimit në rajonin e Pejës/Peć dhe faktin se i pandehuri ishte një figurë publike e njohur. Nuk mund të përjashtohet se disa dëshmitarë (kryesisht oficerë të SHPK-së) kanë mundur të frikohen që të dëshmojnë kundër të pandehurit dhe së këndejmi kanë dhënë dëshmi kundërshtuese mbi faktet dukshëm të padiskutueshme.

Në një rast tjetër pranë Gjykatës së Qarkut në Pejë/Peć, dy të pandehur u akuzuan për udhëheqjen e trazirave në Pejë/Peć, për nxitjen e urrejtjes etnike, fetar dhe racor dhe posedim të paligjshëm të armëve. Gjatë seancave hetimore disa oficerë të policisë ishin dëgjuar. Gjatë dëgjimit të dëshmitarëve në seancat hetimore dëshmimet e tyre ishin hutuese, paqarta dhe kundërshtuese me deklaratat që kishin dhënë para policisë. OSBE-ja kishte vërejtur se dëshmitarët kishin shfaqur një nervozizëm gjatë përgjigjes në pyetje në lidhje me dëshmitarët. Disa nga dëshmitarët identifikuan të pandehurit si udhëheqës të turmës përderisa të tjerët thanë se nuk i kishin parë. Të tjerët madje e kundërshtuan vetvetën duke thënë së pari se i kishin parë e mëvonë duke mohuar një gjë të tillë. Është me rëndësi të përmendet se të dy të pandehurit janë figura të njohura publike në rajon. Megjithatë, disa oficerë të lartë të SHPK-së deklaruan se ata nuk dinin se kush ishin të pandehurit përderisa të tjerët mohuan se i kishin parë diku në kuadër të turmës.

Këto reagime nga ana e oficerëve të policisë lokale, të cilët duhen të kenë njohuri për figurat e njohura publike në rajon dhe të cilët kanë detyrim të posaçëm që të bashkëpunojnë me gjyqësinë në kërkimin e të vërtetës, shkaktojnë shqetësim.

Në një rast tjetër, pranë Gjykatës Komunale në Gjilan/Gnjilane, dy të pandehur ishin akuzuar për shkaktim të rrezikimit të përgjithshëm për shkak se kishin dëmtuar dhe djegur një automjet që i përkiste një serbi të Kosovës, pjesëtar i SHPK-së. Në deklaratat e tyre hetimore, pala e dëmtuar dëshmoi se ai kishte parë personalisht shkatërrimin e veturave të caktuara dhe ai kishte identifikuar si dëshmitar okular një nga të pandehurit që kishte djegur veturën e tij. Pala e dëmtuar kishte shtuar se i akuzuari tjetër ishte identifikuar mëvonë se kishte dëmtuar veturën në fjalë nga një video xhirim. Është me interes për t'u përmendur që gjatë seancës kryesore pala e dëmtuar kishte mohuar se e kishte identifikuar njërin nga të akuzuarit në momentin kritik të kryerjes së veprës penale dhe insistonte se të dy të akuzuarit ishin identifikuar nga kolegët e tij pasi që e kishin shiquar video kasetën. Të pyetur nga prokurori se përse ai po e vë në kontradiktë atë që e ka thënë vetë dhe se a po i bënte dikush presion, pala e dëmtuar deklaroi se ishte nervoz në atë kohë dhe se kishte harruar çka kishte thënë dhe për shkak se kishte qenë nën tension nervor ka mundur edhe të gabojë. Ai vërtetoi se deklarata e tij hetimore i ishte lexuar atij para se t'a nënshkruante.<sup>17</sup>

Në vlerësimin e arsyeve se përse oficerët dukeshin të mos kenë vullnet që të japin deklaratat e tyre duhet të merret në konsideratë fakti se së paku në një rast të ndërlidhur me trazirat

---

<sup>17</sup> Është me interes që gjykata, në aktgjykimin e vet, ka përmendur si dëshmi deklaratën hetimore të palës së dëmtuar dhe jo të dëshmisë së tij gjatë gjykimit. Gjykata nuk vlerësoi për të mos vlerësuar mospajtimet ndërmjet deklaratave mbi këtë fakt të rëndësishëm.

dëshmitar i mbrojtur ishte një oficer i SHPK-së. Në shembullin e mëposhtëm, shqetësimet majde edhe të pjesëtarëve ndërkombëtar të Njësisë Speciale të Policisë ishin bërë tejet të qarta:

Në një rast pranë Gjykatës së Qarkut në Pejë/Peç të akuzuarit i ishte vënë në barrë se kishte udhëhequr turmën në pengimin e personave zyrtar gjatë kryerjes së detyrës së tyre zyrtare. Veprimet e tij pohohet të kenë parandaluar Njësinë Speciale të Policisë (NjSP) për të arritur në disa lokacione me kohë për të parandaluar shkatërrimin që turma ishte duke e bërë në një enklavë serbe. Shumica e dëshmitarëve të prokurorisë të cilët kishin parë çka kishte ndodhur dhe kishin identifikuar të pandehurin si udhëheqës i turmës ishin vetë oficerët e NjSP-së. Megjithatë komandanti e informoi prokurorin se këta oficerë do të dëshmonin në gjykatë vetëm me kushtin e masës mbrojtëse të anonimitetit të plotë; arsyet për këtë ishin frika nga hakmarrja kundër dëshmitarëve të NjSP-së dhe fakti se dëshmia e tyre mund t'i pengojë ata në bashkëveprimin e tyre të përditshëm me popullatën vendëse.<sup>18</sup>

Siç është ilustruar më lartë, në disa procedura penale të ndërlidhura me trazirat, rrethanat bëjnë me dije se oficerët e policisë, duke mos përjashtuar edhe ata ndërkombëtar hezitonin që të japin dëshminë e tyre pranë organeve gjegjëse. Përkundër faktit se kjo mungesë e vullnetit mundet të jetë për arsye të shumta, nuk mundet të përjashtohet fakti se madje edhe oficerët e policisë mund të jenë objekt i frikësimeve që i parandalon ata të bashkëpunojnë në mënyrë të plotë me organet hetimore.

## ***1.2 Shembujt e problemeve të ballafaquara gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së dëshmitarëve në procedurat e ndërlidhura me trazirat***

Siç është përmendur më lartë sipas dijenisë së OSBE-së, masat mbrojtëse të dëshmitarit janë përdorur në një numër të vogël të rasteve ku që të gjithë prej tyre mund të konsiderohen si raste të profilit të lartë dhe që ishin trajtuar nga prokurorët ndërkombëtar. Përkundër problemeve që mund të vazhdojnë në zbatimin e masave të tilla në përgjithësi, kjo pjesë e raportit merret me disa çështje të caktuara që kanë lindur gjatë zbatimit të masave në një rast të ndërlidhur me trazirat.

Në një rast pranë Gjykatës së Qarkut në Gjiilan/Gnjilane, të pandehurit ishin akuzuar për pjesëmarrje në turmën që kishte kryer vepër penale, përderisa disa prej tyre ishin akuzuar mëtutjje për vrasje të rëndë dhe posedim të paligjshëm të armëve. Gjykata lëshoi urdhëra mbrojtës për disa dëshmitar të caktuar pas propozimit të prokurorit.<sup>19</sup> Gjatë dëgjimit të një dëshmitari të mbrojtur në seancën kryesore, pas pyetjes së kryetarit të trupit gjykues, dëshmitari deklaroi se atij/asaj i ishte afruar një gazetar nga një gazetë ditore një ditë para seancës dëgjimore, duke pritur në korridorin e gjykatores. Dëshmitari e vërtetoi faktin se gazetari e kishte intervistuar dhe fotografuar atë. Kryetari i trupit gjykues deklaroi se gazetari në fjalë mund të përballet me pasoja për shkak se ka bërë një fotografi brenda gjykatës pa leje. Është një shqetësim i posaçëm se siç deklaroi gjykata, ky dëshmitar dha një dëshmi e cila ishte kryesisht e ndryshme nga ajo që ai/ajo e kishte dhënë gjatë hetimeve. Duhet të përmendet se gjykimi, përfshirë edhe seancat në të cilat dëshmitarët e mbrojtur dëshmuar ishin mbajtur në seanca publike dhe jo para kamerave.

<sup>18</sup> Asnjë masë e tillë nuk i'u ishte dhënë oficerëve të NjSP të cilët përfundimisht ishin pajtuar që të dëshmojnë pa ta.

<sup>19</sup> Në fillim të seancës kryesore urdhëri mbrojtës përbëhet nga ajo që dëshmitarët të cilët referohen në aktakuzë me initiale do të përfitojnë nga masat që a) shënimet e tyre personale nuk do të përmenden në gjykatë, dhe b) dhe as emrat dhe as inicialet e dëshmitarëve nuk ishin zbluar veçanërisht mediave.

Në rastin e njëjtë, e njëjta gazetë raportoi për deklaratën e dhënë nga një dëshmitar tjetër i mbrojtur. Inicialet e këtij dëshmitari ishin përmendur në artikullin e gazetës së bashku me një informatë që mund të shpiente deri te identifikimi i adresës së dëshmitarit. Duhet theksuar se urdhëri mbrojtës i lëshuar në fillim të seancës kryesore kërkonte që edhe inicialet e dëshmitarëve të mbrojtur të mos zbulohen veçanërisht nga ana e mediave.<sup>20</sup>

Një sërë çështjesh ishin shkak për brengosje në këtë rast. Pikësëpari ishte e paqartë se deri në çfarë mase dëshmitari i cilit ishte fotografuar dhe ata që kishin refuzuar që të hedhin poshtë masat mbrojtëse gjatë gjykimit ishin këshilluar në mënyrë të duhur nga ana e prokurorit dhe gjykata para shqiptimit të masave mbrojtëse. Përkitazi me dëshmitarin i cili ishte fotografuar nuk është e qartë nëse ai apo ajo kishte qenë i informuar në mënyrë adekuate për atë se çfarë sjellje pritet nga ai apo ajo në lidhje me mbrojtjen e identitetit të tij apo saj. Edhe pse ligji nuk kërkon domosdoshmërisht pëlqimin e palës së dëmtuar apo dëshmitarit në mënyrë që masat mbrojtëse të shqiptohen, mund të mbështetet fakti se një pëlqim i tillë është veçanërisht i rëndësishëm kur kemi të bëjmë me zbatimin e duhur të këtyre masave. Në të vërtetë, mund të ketë keqpërdorim të mjeteve në qoftë se masat mbrojtëse janë vendosur nga gjykata, mirëpo dëshmitari që mëtohet të mbrohet me këto masa mbrojtëse është ai i cili nuk i përmbahet plotësisht atyre. Në njërën anë, sjellja e cila mund të rezultojë në zbulimin e identitetit të dikuj, apo e cila në të vërtetë e zbulon atë mund të nënkuptohet sikurse dëshmitari në të vërtetë nuk i frikësohej kërcënimit; në anën tjetër, një sjellje e tillë mund gjithashtu të nënkuptojë se dëshmitarët nuk perceptojnë masat mbrojtëse si adekuate për të parandaluar kërcënimin.

Krahas kësaj, duket se dëshmitari të cilit i është afuar gazetari ishte në koridor të gjykatores përderisa po priste që të dëshmojë në gjyq: kjo ngrit pyetjen se përse këtij dëshmitari nuk i është ofruar një hapësirë e caktuar që të pres në vend se të qëndrojë në një lokacion publik ku dikush mund të jetë më i rrezikuar se do të identifikohet dhe të lidhet me procedurat penale.

Për më tepër, duket se ekziston një huti se a ka pasur në të vërtetë ndonjë veprim që është ndërmarrë për të ekzaminuar sjelljen e gazetarit në pajtim me atë çka kryetari i trupit gjykues kishte deklaruar në mënyrë të hapur në gjykatë. Kryetari i trupit gjykues deklaroi në gjykatë se rojet i kishin dorëzuar një raport kryetarit të gjykatës së qarkut dhe se ky i fundit kishte deklaruar se do të merr veprime në këtë drejtim. Megjithatë, në një intervistë me OSBE-në, kryetari i gjykatës pohoi se nuk kishte qenë i informuar për këtë incident qoftë nga rojet apo nga kryetari i trupit gjykues. Së fundi publikimi në gazetë i së paku një artikulli duke zbuluar inicialet e dëshmitarit të mbrojtur kishte shkelur masën mbrojtëse.

### ***1.3. Çështjet përkitazi me sigurinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve***

OSBE-ja nuk ishte përballur me shembuj konkret të frikësimit të gjyqtarëve apo prokurorëve në lidhje me trajtimin e rasteve të ndërlydhura me trazirat. Sidoqoftë, në bisedat e tyre me OSBE-në, një numër i gjyqtarëve dhe prokurorëve si vendës ashtu edhe ndërkombëtar pohuan se ekziston frika e keqtrajtimin sidomos në rradhët e gjyqtarëve vendës nëse vendosin të merren me rastet e ndërlydhura me trazirat. OSBE-ja gjithashtu ka pranuar informata se në disa procedura kundër udhëheqësve të pohuar të trazirave kishte përpjekje të emërohen gjyqtarë vendës për konfirmimin e aktakuzës dhe për seancën kryesore. Megjithatë, gjyqtarët vendës hezitonin që të jenë të përfshirë në këto procedura së paku si gjyqtarë të seancës së konfirmimit apo kryetarët e trupit gjykues.

Gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtar të jenë të përfshirë në rastet më të ndjeshme të trazirave. Për këtë arsye, si duket se gjyqësia vendëse dhe organet prokuroriale nuk ishin testuar në mënyrë të plotë për të dëshmuar se janë në gjendje të merren me rastet e ndjeshme

<sup>20</sup> Lexo fusnotën 19 si mëlartë.

të dhunës ndëretnike në mënyrë efektive pa ndonjë përfshirje të gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtar.

## **2. Çështjet që kanë të bëjnë me mbledhjen e dëshmive në rastet e trazirave**

Krahas mungesës së vullnetit të dëshmitarëve që të vijnë në gjykatë dhe të dëshmojë, mbledhja e dëshmive në rastet penale të ndërlidhura me trazirat ishte penguar mëtutje nga një sërë faktorësh tjerë. Kjo përfshinë faktin se një numër i personave ishin zhvendosur si rrjedhojë e dhunës dhe si pasojë e kësaj nuk do të kenë mundësi që të dëgjohej nga ana e organeve të drejtësisë. Për më tepër, pjesëtarët e caktuar ndërkombëtar të organeve për zbatimin e ligjit dhe forcave të sigurisë që kanë qënë dëshmitarë të trazirave e kanë lëshuar territorin e misionit të OSBE-së, përderisa organet hetimore dhe prokuroriale nuk kishin siguruar deklaratat nga ta që do të mund të shfrytëzoheshin në gjykatë. Krahas kësaj duket se dëshmimi i oficerëve të policisë dhe pjesëtarëve të forcave të sigurisë ishte ndonjëherë i vështirë të mirrej.

Është e vlefshme të ceket se kah fundi i vjeshtës 2004, Ministria Serbe e Punëve të Brendshme i ofroi Departamentit të drejtësisë, dhe gjithashtu edhe “Operacionit Thor”, një vëllim me tregues dhe 46 vëllime me informata dhe deklarata të mbledhura nga serbët e Kosovës të cilët kanë ikur për në Serbi menjëherë pas trazirave. Ky material ishte në gjuhën serbe, kështuqë përkthimi ishte arranzhuar në gjuhën angleze dhe shqipe. Vëllimi me tregues ishte përkthyer së pari ashtuqë të ofrojë udhëzime në lidhje me përdorimin e informatave. Materiali i cili ishte lidhur me hetimet e nisura paraprakisht i’u ishte bashkangjitur dosjeve përkatëse. Në dhjetor 2004, menaxhimi i “Operacioni Thor” kishte ndryshuar, dhe rastet të cilat mund të dorëzoheshin për ndjekje penale në gjykata i’u ishin përcjellur gjykatave; të gjitha rastet tjera vazhduan të hetohen deri kur “Operacioni Thor” ishte shpërnda në mars 2005. Hetimet në rastet e ndërlidhura me trazirat për momentin trajtohen nga ekipet e krimit regional.

### **2.1 Vështirësitë në marrjen e dëshmive si rrjedhojë e zhvendosjes për shkak të dhunës**

Gjatë trazirave vlerësohet se rreth 4,200 persona ishin zhvendosur si rrjedhojë e dhunës.<sup>21</sup> Rrjedhimisht shumë palë të dëmtuara dhe dëshmitarë nuk ishin lehtë të qasshëm nga ana e organeve në fazat e ndryshme të procedurës. Megjithatë, duket se në një numër të rasteve organet nuk kanë vepruar në mënyrë adekuate në sigurimin e dëshmive të personave të tjerë.

Në një rast pranë Gjykatës Komunale në Gjilan/Gnjilane, i akuzuari ishte shpallur fajtor më 28 qershor 2004 për vepra penale të pjesëmarrjes në turmë që ka kryer vepër penale të pengimit të personave zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare. I pandehuri është gjetur se ka marrë pjesë në turmën që ka hyrë në oborrin e një shtëpie të banuar nga një serb të Kosovës, dhe e cila turmë i’u kishte shkaktuar lëndime të rënda trupore dy serbëve të Kosovës. Në asnjë moment gjatë gjatë këtyre procedurave palët e dëmtuara nuk ishin dëgjuar, për shkak se ishin zhvendosur, përderisa gjykata nuk kishte bërë përpjekje shtesë për t’i gjetur ata. Është me interes që në një rast tjetër penal një i akuzuar tjetër u gjykua për të njëjtat fakte dhe për lëndimin e të njëjtave viktima,<sup>22</sup> mirëpo pranë Gjykatës së Qarkut në Gjilan/Gnjilane. Është e njohur nga ky rast se gjyqtari hetues dhe prokurori, të dy ndërkombëtar janë takuar me palët e dëmtuara në Serbi më 17 qershor 2004; një nga palët e dëmtuara ishte thirrur dhe paraqitur në seancën kryesore të pandehurit të dytë.

<sup>21</sup> Lexo *Raportin Global të UNHCR-së 2004*, faqe 248.

<sup>22</sup> I akuzuari në rastin e dytë është akuzuar për nxitje të urrejtjes, mosmarrëveshjeve apo tolerancës ndërmjet grupeve etnike që jetojnë në Kosovë në bashkëpjesëmarrje në shkaktimin e rrezikut të përgjithshëm me zjarr apo lloje tjera të energjisë që rezulton në lëndim të rëndë trupor si dhe shkaktimin e rrezikut të përgjithshëm që rezulton në dëmin substancial material.

Është e paqartë se deri në çfarë mase gjykata në rastin e parë kishte ditur për vendndodhjen e palëve të dëmtuara para përfundimit të seancës kryesore. Nëse autoritetet në këtë rast nuk kanë ditur për vendndodhjen e palëve të dëmtuara mund të tregojë për një mungesë të shkëmbimit të informatave ndërmjet organeve gjyqësore që merren me rastet e ndërlidhura me trazirat. Nëse në anën tjetër gjykata ka ditur për vendndodhjen e palëve të dëmtuara, mirëpo nuk ka realizuar dëgjimin e tyre në cilësi të dëshmitarit, atëherë kjo mund të bëjë me dije se në të vërtetë ka pasur mungesë të zotimit nga ana e organeve prokuroriale dhe gjyqësore për hetimin e rastit në mënyrë të denjë.

Në shembullin e dytë pranë Gjykatës Komunale në Gjiilan/Gnjilane, një i akuzuar ishte akuzuar më 24 mars 2004 për vjedhje të rëndë dhe shkaktim të rrezikut të përgjithshëm. Sipas aktakuzës, më 17 dhe 18 mars 2004 i pandehuri kishte hyrë në shtëpinë e një serbi të Kosovës (i paindentifikuar në aktakuzë) dhe vodhi gjëra. Në lidhje me pikën e dytë të aktakuzës, aktakuzë përshkruan se më 17 mars 2004 i pandehuri siç pohohet kishte ndezur shtëpinë e një serbi (identifikuar në aktakuzë) duke përdorur benzinë dhe duke shkaktuar dëmtim të konsiderueshëm material dhe rrezikim të jetës. Në asnjë moment të procedurës palët e dëmtuara ishin dëgjuar në cilësi të dëshmitarit. Përkitazi me pikën e dytë të aktakuzës, në pranimin e fletëthirrjeve për gjyq të datës 22 qershor 2004 shkruan se pala e dëmtuar ishte zhvendosur në Serbi. Gjatë seancës kryesore, prokurori ndryshoi aktakuzën duke tërhequr akuzën e dytë dhe kualifikuar veprën e parë penale si një krim të pranimit të gjësendeve të vjedhura.

Në këtë rast gjykata nuk është prpjekur madje për të identifikuar palët e dëmtuara. Për më tepër, përkitazi me palën e dëmtuar e cila ishte identifikuar në aktakuzë për shkak të faktit se ai ishte zhvendosur në Serbi ai nuk ishte dëgjuar gjatë procedurës. Gjithashtu gjatë gjykimit as gjyqtari nuk njohi mungesën e palës së dëmtuar dhe as prokurori publik nuk ishte i pranishëm se pala e dëmtuar nuk ishte e pranishme dhe se nuk mund të dëgjohet.

## ***2.2 Vështirësitë në marrjen e dëshmive si rezultat i personave që përfundojnë misionin***

OSBE-ja për më tepër ka vërejtur se në disa raste të veçanta, mund të jetë që autoritetet hetimore nuk janë prpjekur në mënyrë proaktive që të mbledhin dëshmi nga oficerët ndërkombëtar të policisë dhe ushtarët e KFOR-it të cilët kanë përfunduar detyrën e tyre dhe kanë lëshuar misionin. Në disa raste të caktuara organet hetimore kanë dështuar që t'i sigurojnë këto deklarata me kohë të cilat mund të shfrytëzohen në gjykatë dhe duket se gjykatat nuk kanë bërë prpjekje substanciale për t'i sjellur dëshmitarët nga jashtë që të dëshmojnë personalisht gjatë gjykimit. Kjo rezultoj në tërheqjen e akuzave për shkak të mungesës së provave në rastet vijuese.

Në një rast pranë Gjykatës Komunale në Pejë/Peć kundër një të pandehuri i cili siç pohohet ka marrë pjesë në turmën që ka kryer vepër penale, njësisia e policisë e "Operacioni Thor" ka dorëzuar rastin prokurorit publik duke e përmendur në mënyrë shprehimore se dëshmia e vetme kundër të dyshuarit ishte dëshmimi i një ushtari të KFOR-it i cili do t'a lëshojë misionin brenda një periudhe të shkurtër kohore. Oficeri nga "Operacioni Thor" shprehimisht e ka nxitur prokurorin që të merr në pyetje ushtarin para datës kur ai është dashur t'a përfundojë misionin në praninë e avokatit mbrojtës të pandehurit për të siguruar që dëshmia e tillë të mund të përdoret si provë në gjykatë.<sup>23</sup> Megjithatë, ushtari i KFOR-it e ka lënë misionin pa dhënë ndonjë dëshmi dhe si rrjedhojë prokurori nuk ka mundur të mbledh dëshmi të nevojshme për të përkrahur aktakuzën dhe kështu rasti është tërhequr.

---

<sup>23</sup> Neni 156(2) KPPPK.

Në këtë shembull, qoftë për shkak se policia i'a ka dorëzuar rastin prokurorit me vonesë apo për shkak se ky i fundit nuk ishte i zellshëm aq sa duhet për të ndërmarrë hapa të nevojshëm që t'a ftoj dhe merr në pyetje dëshmitarin, dëshmitari e ka lëshuar misionin pa dhënë ndonjë dëshmi dhe kështu rasti është dashur që të tërheqet.

Në një rast të dytë pranë Gjykatës së Qarkut në Prizren, aktakuza ishte ngritur më 18 qershor 2004 duke i vënë në barrë personit të akuzuar kryerjen e veprës penale të tentimit për shkakim të rrezikut të përgjithshëm, sulmin kundër personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës së tij zyrtare dhe pjesëmarrja në turmën që kryen veprën penale. Një zyrtar ndërkombëtar i policisë ishte dëgjuar në cilësi të dëshmitarit nga ana e gjyqtarit hetues më 8 prill 2004 në mungesë të avokatit mbrojtës të të pandehurit, në deklaratën e tij, dëshmitari e ka identifikuar qartë të akuzuarin si person që ka tentuar të shkaktojë rrezikim të përgjithshëm. Në seancën e konfirmimit të mbajtur më 21 korrik 2004, i akuzuari ishte deklaruar fajtor për tri veprat penale. Në fillim të seancës së gjykimit prokurori publik ndryshoi aktakuzën me tërheqjen e akuzës së parë të shkakimit të rrezikut të përgjithshëm për shkak të faktit se dëshmitari i vetëm për pikën e parë të aktakuzës kishte lëshuar misionin.

Në këtë rast, avokati mbrojtës madje nuk ishte ftuar që të merr pjesë në seancën hetimore në të cilën ishte pyetur dëshmitari nga ana e ndjekjes penale. Aktakuza propozoi dëgjimin e këtij dëshmitari gjatë gjykimit. Megjithatë, duket se organet nuk kanë marrë parasysh faktin se dëshmitari mund t'a lëshojë zonën e misionit. Për më tepër nuk janë ndërmarrë kurrfarë masash të duhura për të siguruar se ai është marrë në pyetje nga ana e palës mbrojtëse para se të shkojë nga Kosova kështuqë deklarata e dhënë gjatë hetimeve të mund të përdoret gjatë gjykimit. Në anën tjetër kthimi i dëshmitarëve në Kosovë me qëllim të dëgjimit të dëshmisë së tij në gjykatë nuk duket të jetë parashikuar para se prokurori të tërheq akuzat e caktuara.

### ***2.3 Vështirësitë në marrjen e dëshmive si rrjedhojë e mos paraqitjes së dëshmitarit para gjykatës dhe mos ofrimi i materialit të kërkuar të provave***

Në një numër të konsiderueshëm të lëndëve, oficerët e policisë nuk janë paraqitur në gjykatë për të dhënë dëshmi edhe pse janë thirrur me kohë në gjykatë.<sup>24</sup>

Në një rast pranë Gjykatës Komunale në Gjilan/Gnjilane, i akuzuari ishte akuzuar për pjesëmarrje në turmën që ka kryer veprën penale dhe pjesëmarrjen në grup që ka rrezikuar personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare. Gjatë hetimeve, përpos të akuzuarit, dy officer të SHPK-së kishin dhënë deklaratat e tyre prokurorit publik. Këta dy dëshmitar ishin thirrur me kohë gjatë seancës kryesore; përkundër këtij fakti ata kanë dështuar që të paraqiten para gjykatës. Pa hulumtuar mëtutjje për arsyet e mungesës së dëshmitarëve, gjykata ka vendosur me pëlqimin e palëve se për hir të efikasitetit të procedurës ata nuk do të dëgjojnë këta dëshmitar mirëpo do të lexojnë deklaratat e tyre të dhëna gjatë procedurës hetimore.<sup>25</sup>

<sup>24</sup> Neni 158(1) KPPPK thotë se “Si dëshmitar thirret personi për të cilin besohet se mund të jep njoftime për veprën

penale, për kryerësin dhe për rrethanat e rëndësishme për procedurën penale.” Paragrafi i dytë i të njëjtës dispozitë përcakton detyrimin e përgjithshëm të secilit dëshmitar që t'i përgjigjet thirrjeve për të dëshmuar përpos nëse nuk parashikohet ndryshe me KPPPK. Në lidhje me SHPK-në duhet të ceket se doracak i politikave dhe procedurave përcakton që një politikë për paraqitjen e policëve të SHPK-së në gjykatë duke deklaruar që “nëse një officer i SHPK-së urdhërohet që të paraqitet para gjykatës, ai/ajo është i obliguar që të paraqitet në gjykatë në kohën dhe vendin e theksuar.” *Lexo doracakun e politikave dhe procedurës*, Seksioni për Zhvillim të Politikave i SHPK-së, numri i politikës P-1.41, që ka hyrë në fuqi prej 1 tetorit 2002.

<sup>25</sup> Pas leximit të këtyre deklaratave, avokati mbrojtës i'u kundërshtoi atyre. Është me rëndësi të ceket se avokati mbrojtës nuk ka arsyetuar kundërshtimin e tij me argumente ligjore. Më 28 qershor 2004, i akuzuari është shpallur fajtor dhe dënuar me gjashtë muaj burgim.

Në një rast pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë/Priština, të pandehurit ishin akuzuar për tentim vjedhje në bashkëpjesëmarrje. Një officer i SHPK-së në mënyrë të rregullt ishte ftuar si dëshmitar në gjykim të mbajtur më 23 shtator mirëpo ai nuk u paraqit në gjykatë. Asnjë arsyetim nuk është dhënë sa i përket mungesës së këtij oficeri dhe së këndejmi gjykata nuk ndër morri kurrfarë veprime që të sigurojë paraqitjen e dëshmitarit para gjykatë. Në vend të kësaj prokurori publik tërheqi propozimin e tij për të dëgjuar këtë dëshmitar dhe gjykata e miratoi atë pa ndonjë diskutim të mëtutjeshëm.<sup>26</sup>

Në një rast tjetër pranë Gjykatës Komunale në Gjilan/Gnjilane, i akuzuari ishte akuzuar për tentim vjedhje të rëndë. Dy officer të SHPK-së kanë dhënë dëshmitë e tyre para prokurorit publik në mungesë të pandehurit apo avokatit mbrojtës. Ata mëtutje ishin thirrur në mënyrë të duhur për seancën kryesore të caktuar për 20 maj 2004. Nga këta dy oficerë, njëri nga ta paraqiti për atë seancë dhe ishte thirrur në mënyrë gojore të vijë në gjykatë më 31 maj 2004. Në një seancë të mëvonshme, asnjëri nga këta oficerë nuk u paraqit përderisa shkresave të lëndës u mungojnë fletëdorëzimi i thirrjeve në gjyq për oficerin e dytë. Me pëlqimin e palëve dhe me qëllim të mos vonesës së procedurës, gjykata ka vendosur që t'i fus deklaratat e këtyre dëshmitarëve në procesverbal. I akuzuari i'u ka kundërshtuar këtyre deklaratave. Mund të ceket se këto dy deklarata formojnë bazë për shpalljen fajtor të të akuzuarit për akuzat që i janë vënë në barrë.

Në rastet e sipërpërmendura, policët nuk ishin paraqitur si dëshmitarë kur ata ishin thirrë në mënyrë të rregullt, dhe nuk kishin dhënë ndonjë arsyetim të vlefshëm para gjykate. Dhe përveç faktit se gjykata nuk kishte ndërmarrë ndonjë masë ligjore për detyrimin e paraqitjes së tyre, siç duket për t'i dhënë përparësi përfundimit sa më të shpejtë të rasteve, gjithashtu është për t'u brengosur që policët e SHPK-së nuk u kishin ofruar bashkëpunim të plotë autoriteteve gjyqësore kur kjo ishte kërkuar.

Dhe së fundi, në disa raste, duket se KFOR-i nuk kishte ofruar dëshmi të cilat do të përkrahnin ankesat kundër të pandehurve.

Në një rast para Gjykatës për Kundërvajtje në Gjilan/Gnjilane, i dyshuari ishte ngarkuar në bazë të nenit 18 (10) të ligjit mbi qetësinë dhe rendin publik.<sup>27</sup> Ai kishte mohuar se kishte marrë pjesë në protestat e 18 marsit të vitit 2004, ose që kishte gjuajtur gurë në drejtim të KFOR-it, edhe pse ai ishte arrestuar nga KFOR-i. Gjykata e kishte thirrur një polic të SHPK-së dy herë që ai të paraqitej në gjykatë, në prill dhe në dhjetor të vitit 2004; polici nuk ishte paraqitur kur ai ishte ftuar.<sup>28</sup> Gjykata e kishte ndërprerë gjykimin më 20 dhjetor 2004 në mungesë provash. OSBE-ja ishte informuar nga gjyqtari se KFOR-i kishte premtuar se ata e kishin një shirit filmi në dispozicion dhe fotografitë të cilat ata do t'i binin në gjykatë në mënyrë që të identifikohet i pandehuri. Sidoqoftë, asgjë nuk ishte prezantuar para gjykate. Dhe më tutje, kryetari i gjykatës për kundërvajtje kishte shtuar se, edhe përkundër kontaktimit të KFOR-it, gjykata gjithashtu e kishte kontaktuar komandantin rajonal të policisë për të ofruar më shumë dëshmi, por ai ishte përgjigjur se nuk kishte pasur asnjë dëshmi.

<sup>26</sup> Më 23 shtator 2004, gjykata shqiptoi masat edukuese të mbikëqyrjes së shtuar nga prindërit e tyre për të dy të pandehurit, të dy të mitur.

<sup>27</sup> Neni 18 (10) i ligjit mbi qetësinë dhe rendin publik (Gazeta zyrtare e KSAK, nr. 13/81) parasheh që "se për kundërvajtje do të dënohet deri në dy muaj [...] atë i cili e nënçmon organin shtetëror, organizatat e punës së bashkuar, organizatën dhe bashkësi tjera vetë- qeverisëse, i cili shqetëson ose e ofendon ndonjë person zyrtar në detyrë zyrtare, vepra e cila është bërë nën autoritetin e tij."

<sup>28</sup> Sipas gjyqtarit, polici kishte ardhur në gjykatë dhe e kishte informuar gjyqtarin se ai e kishte hartuar raportin e policisë dhe e kishte përgatitur rastin. Megjithatë, kjo nuk ishte regjistruar në asnjë regjistër të mundshëm në dosjet e rasteve.



Në një rast tjetër para Gjykatës për Kundërvajtje në Gjilan/Gnjilane, i dyshuari ishte ngarkuar sipas nenit 18 (10) të ligjit mbi qetësinë dhe rendin publik.<sup>29</sup> Ai ishte dëgjuar nga gjykata më 19 mars 2004 dhe deklaroi se kishte marrë pjesë në protesta por nuk pranoi të kishte gjuajtur gurrë në drejtim të policisë. I vetmi dëshmitar në këtë rast, një polic i SHPK-së, kishte dëshmuar më 8 dhjetor të vitit 2004 që në ditën kritike ajo thjeshtë kishte pranuar dhe përgatitur rastin që përfshinte këtë të pandehur, i cili rast ishte sjellur nga KFOR-it. Policja e SHPK-së kishte deklaruar se e kishte lutur KFOR-in që të sjellë dëshmi për të vërtetuar veprën, por asnjë dëshmi nuk ishte ofruar. Më 28 dhjetor të vitit 2004, gjykata e kishte suspenduar procedurën në mungesë provash<sup>30</sup>.

Kjo mungesë e bashkëpunimit në mes KFOR-it dhe sistemit gjyqësor është një çështje brengosëse, kur merret parasysh se gjatë trazirave të marsit KFOR-i ishte përfshirë shumë në rivënien e qetësisë dhe rendit publik, dhe kështu, shumë ushtarë kishin qenë dëshmitarë të veprave penale dhe/ose kishin mbledhur dëshmi të cilat do të ishin shumë të dobishme për gjykatat.

#### **2.4 Çështjet tjera që kanë të bëjnë me mbledhjen e dëshmive**

OSBE gjithashtu kishte pranuar informata nga hetuesit e policisë të cilat shfaqin shqetësime serioze sa i përket mbledhjes së dëshmive që kanë të bëjnë me incidentet e trazirave. Duket se, në disa raste palët e dëmtuara ishin pyetur disa herë nga policët e ndryshëm.<sup>31</sup> Mund të pritet që një polic i cili është caktuar për rast, përveç leximit të deklaratës së mëparshme të dhënë nga dëshmitari, do të dëshironte që ta pyes drejtpërdrejt dëshmitarin për dëshmi. Megjithatë, në disa raste specifike duket se deklaratat e mëparshme të marra nga pala e dëmtuar dhe nga dëshmitarët kanë munguar nga shkresat e lëndës. Kjo është alarmante për shkak se jo vetëm që zbulon se nuk ka pasur koordinim,<sup>32</sup> organizim dhe profesionalizëm në autoritetet e policisë, por kjo mund të ngrisë edhe dyshimin se dëshmia e pranuar është mënjanuar qëllimisht nga/ose nuk është e përfshirë në shkresat e lëndës së caktuar. Për më shumë, është pretenduar se llojet tjera të dëshmive, siç janë dëshmitë me fotografi, gjithashtu mungojnë nga shkresat e lëndës, përderisa ekziston informata që sugjeron që një dëshmi e tillë i është dorëzuar autoriteteteve të policisë. Nëse pretendimet e tilla në të vërtetë janë të vërtetuara, nuk është e qartë se një humbje e tillë e provave materiale është bërë për shkak të mos organizimit apo ndonjë shkakut tjetër.

Dhe si një tjetër brengë është edhe ankthi të cilin palët e dëmtuara dhe dëshmitarët e kanë ndier kur në mënyrë të përsëritur është kërkuar nga ata që të japin shpjegimet e tyre për ngjarjet. Kjo sjell deri te mungesa e besueshmërisë në zotësinë e autoriteteteve të policisë për të hetuar në mënyrë të rregullt incidentet.

Në situatat e trazirave në mënyrë të përgjithshme pranohet se dëshmitë me video-inçizime mund të luajnë rol të madh si përgjigje ndaj sistemit të drejtësisë penale.<sup>33</sup> Shiriti i videos

<sup>29</sup> Shih *supra* futnota 27.

<sup>30</sup> Procedura ishte suspenduar në bazë të nenit 198(1) pika 8 e Ligjit mbi Kundërvajtjet (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës, nr. 23/79)

<sup>31</sup> Gjithashtu duket se një numër i deklaratave të mbledhura ishin të kualitetit të dobët dhe nuk ishin gjithëpërfshirëse, kështu policët e caktuar për to ishin detyruar që sërish t'i dëgjojnë dëshmitarët.

<sup>32</sup> Është e dukshme se nuk ka pasur pranim- dorëzim të mirëfillt të rasteve nga Njësi rajonal për krime dhe Operacionit Thor, përderisa disa njësite kishin refuzuar që të dorëzojnë rastet.

<sup>33</sup> Shiko Alan Carling, Darrel Davies, Amritha Fernandes-Bakshi, Neil Jarman, dhe Peter Nias, *Fer drejtësia për të gjithë? Përgjigje e sistemit për drejtësi penale ndaj trazirave të Bradford të korrikut të vitit 2001*, e publikuar nga Programi për një qytet të qetë, Universiteti i Bradfordit në bashkëpunim me Trustin bamirës të Joseph Rowntree (2004) [i njohur si "Raporti Bradford"] i cili mund të gjendet në <<http://betterbradford.org.uk/Documents/Fair%20Justice%20For%20All.pdf>> (për herë të fundit ishte

mund të përdoret si dëshmi në mënyra të ndryshme, duke përfshirë: a) ofrimin e pamjes së përgjithshme të situatës së trazirës në të cilën janë kryer veprat individuale; b) identifikimin e individëve të cilët kanë marrë pjesë në trazira ose të cilët kanë orkestruar apo udhëhequr veprimet e turmës ose grupit; dhe c) paraqitjen e veprimeve të forcave të sigurisë dhe të rendit se si i janë përgjigjur atyre trazirave.<sup>34</sup>

Për trazirat e marsit të vitit 2004 janë dhënë në dispozicion disa shirita të videos, dhe video dëshmitë janë shfrytëzuar në disa raste penale. Megjithatë, video incizimet ndonëse nuk kanë luajtur rol të rëndësishëm dëshmues. Sipas zyrtarëve të “Operacioni Thor”, për shkak të arsyes së shumica e video incizimeve janë bërë nga mediat dhe disa nga kontigjentet e KFOR-it, ka pasur probleme me përdorimin e këtyre inçizimeve si dëshmi. Në fakt, video shiritat përqendrohen në senzacionin i cili ishte krijuar nga këto trazira, më shumë se në faktet të cilat do të mund të konstituonin dëshmitë e gjyqit. Në anën tjetër, video incizimet e bëra nga ana e KFOR-it, nganjëherë kanë qenë të kualitetit të dobët ose nuk janë ndarë me autoritetet hetuese. Sipas “Operacioni Thor”, nuk kishte pasur video të inçizuara policia vendore, dhe për më shumë, duket se autoriteteve për zbatimin e ligjit në Kosovë iu mungojnë policët e trajnuar dhe të specializuar për të mbledhur dëshmitë e videos për këto rrethana të trazirave civile.<sup>35</sup>

Pa marr parasysh faktin se video dëshmitë mund të jenë shumë të dobishme për procedurën penale, në lidhje me rastet e trazirave, ato nuk duhet të konsiderohen si dëshmi të vetme për veprat e kryera kundër rendit publik. Përvoja si nga Kosova, ashtu edhe nga juridiksionet tjera vëjnë në pah se, edhe kur janë në dispozicion dëshmitë me video, është pak e dobishme nëse nuk ekziston pajtueshmëria e gjërë mbi procesin penal gjyqësor. Në shembujt nga juridiksionet tjera, dëshmitë me video janë treguar si shumë efektive kur duke i përcjellur posterët ose fushatat tjera identifikuese, anëtarët e publikut kishin qenë të gatshëm që t’i denoncojnë të dyshuarit tek organet përkatëse ose t’i inkurajojnë ata që të dorëzohen në polici.<sup>36</sup> Sa i përket trazirave të marsit 2004 në kontekstin e Kosovës, mundet që lirisht të deklarohet se publiku nuk kishte demonstruar këtë pëlqim të gjerë në procedurat penale.

### 3. Vonesat në rastet që ndërlidhen me trazirat

Nga 426 raste që ndërlidhen me trazirat, 110 janë ende të pakryera. Kështu shumica e rasteve janë kompletuar, megjithatë, OSBE-ja ka vërejtur vonesa në një numër të konsiderueshëm procedurash.

Gjatë trazirave të marsit 2004 ka ngjarë një numër i madh i incidenteve brenda një afati shumë të shkurtër kohor. Është e dukshme se këto raste kishin krijuar një barrë plotësuese në aktivitetet tanimë të stërngarkuara të autoriteteve të policisë, prokurorisë dhe gjykatave. Kështu, deri në një shkallë të caktuar, edhe është pritur se një ngarkesë e tillë me raste do të shkaktonte vonesa të mëtutjeshme në administrimin e drejtësisë. Megjithatë, edhe përkundër faktit se këto raste do të duhej të trajtoheshin si prioritare nga sistemi gjyqësor,<sup>37</sup> OSBE-ja

---

qasur më 10 gusht 2005). Në faqen 16 të këtij dokumenti autorët kanë theksuar se: “është shumë vështirë të theksohet rëndësia e dëshmimeve me video incizime për tërë kursin e drejtësisë penale si përgjigje ndaj 7/ 7/ 01 [data e trazirave të Bradfordit] [...] është shumë e mundur që nuk do të mund të bihen asnjë ngarkesë për këto trazira me ndonjë prospekt të sigurimit të dënimeve si mungesë e videove, dhe është shumë e mundur që një numër i këtyre ngarkesave- ndjekjeve penale ishin të kufizuara, në maksimum prej mëse 20 rasteve, prej 178 sa ishin paraqitur faktikisht.”

<sup>34</sup> Shiko Raportin Bradford, *supra*. Informacion i tillë gjithashtu ishte ofruar për OSBE- në nga ish-udhëheqësi i Operacionit Thor.

<sup>35</sup> OSBE ishte informuar se se zyrtarët e tillë të trajnuar për dëshmi me video inçizime zykonisht gjenden nëpër ekipet e mjekësisë ligjore dhe juridiksione tjera.

<sup>36</sup> Shiko Raportin e Bradfordit, *supra* futnota 33, faqe. 16- 17.

<sup>37</sup> Standardet e sundimit të së drejtës theksojnë se Policia e UNMIK- ut (si ajo CIVPOL, ashtu edhe SHPK) duhet që të hetojnë krimet pa ndonjë frikë ose favorizim dhe njëanshmëri gjinore, me përparësi të veçanta për hetimin e krimeve të dhunës të kryera gjatë ngjarjeve të 17- 19 mar 2004 (Standardi 1.1 i

kishte vëzhguar se në disa raste, është e mundur që autoritetet kompetente nuk i kanë ndërmarrë të gjithë hapat e duhur në mënyrë që të sigurojë që është arritur përfundimi i këtyre rasteve në afat të arsyeshëm kohor.

“Operacioni Thor” ishte formuar në maj të vitit 2004 dhe kishte pasur mandat që të hetojë krimet e kryera gjatë trazirave të marsit. Në fund të vitit 2004, “Operacioni Thor” kishte hetuar ose po hetonte përafërsisht 1,200 incidente penale të trazirave. Sipas informatave të pranuar nga udhëheqësia e “Operacioni Thor”, ky njësit ishte ballafaquar me një sërë problemesh gjatë hetimeve të incidenteve që ndërlidheshin me trazirat e marsit. Para së gjithash, numri më i madh i personelit të caktuar për njësitin ishte 140, prej të cilëve përafërsisht 90 ishin caktuar si hetues.<sup>38</sup> Dhe nga përfaqësuesit e “Operacioni Thor” është theksuar se numri i hetuesëve ishte i vogël për t’ia dalur me të gjitha rastet që iu kishin caktuar.

Një çështje tjetër brengosëse është fakti se të gjithë hetuesit nuk i kishin përmbushur kërkesat profesionale për pozitat e tyre, sa i përket aftësive për të folur gjuhën angleze dhe të përvojës aktuale për hetuesi. Për më shumë, një numër i hetimeve ishte i ndikuar nga pengesat të paraqitura për shkak të faktit se hetuesit do të kryenin kontratat e tyre, dhe se do ta linin misionin. “Operacioni Thor” gjithashtu e kishte krijuar një bazë elektronike të të dhënave në të cilën duhej të regjistrohej çdo veprim që ndërlidhet me rastet e trazirave.<sup>39</sup> Përveç pranimit të të dhënave, kjo bazë e të dhënave gjithashtu do të mund të shërbente për të zbuluar informacione nga ndonjë hetim që do të ishin të dobishme për hetime tjera. Megjithatë, OSBE ishte informuar nga përfaqësuesit e “Operacioni Thor” se kjo bazë e të dhënave faktikisht ishte e pa shfrytëzuar dhe gjithashtu e pashfrytëzueshme.<sup>40</sup>

Në përmbledhje, “Operacioni Thor” do të mund të arrinte rezultate më efektive nëse do të kishte resurse të duhura, përkrahje, organizim, si dhe koordinim me njësitet tjera të policisë. Njëra nga pasojat e mangësive të sipërpërmendura do të ishte edhe vonesa e hetimeve të policisë për veprat e kryera të ndërlidhura me trazirat. Dhe një pasojë tjetër e madhe do të ishte edhe dështimi në sigurimin e dëshmimeve adekuate për ndjekjen penale të rasteve.

Në një rast para Gjykatës Komonale në Pejë/Pec, i pandehuri akuzohej me propozimkuzë për kryerje të veprës penale “pjesëmarrje në grupin që pengon personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare”. Raporti i policit i cili cekë veprimet që i kishte ndërmarrë për të intervistuar të dyshuarin dhe personat tjerë si dëshmitarë mbante datën 12 prill 2004. Raporti i njësitit hetues të policisë i datës 6 qershor 2005 i adresuar në Prokurorinë Komonale të Pejë/Pec përshkruan të gjitha ngjarjet që kishin ndodhur më 17 mars 2004 dhe thjeshtë kishte përsëritur atë që i dyshuari e kishte thënë në deklaratën e tij të dhënë në polici. Ky raport arrin tek përfundimi i përgjithshëm se “nga të gjitha dëshmitë që i kishte mbledhur policia sa i përket kryerjes së veprës [...] nuk mundej që përtej çdo dyshimi të dëshmohet kundër të

---

staqndardeve për sundimin e së drejtës- plani për implementimin e standardeve për Kosovën). Dhe më tutje, ka qenë një ndienjë e përgjithshme se gjyqësia kishte qenë e vetëdijshme se këto raste duhet trajtuar si raste me përparësi. Gjithashtu edhe Gjykata europiane për të drejtat e njeriut kishte theksuar se “veprat e motivuara nga urrejtja etnike që shpiejnë në privimin e jetës minojnë krijimin e shoqërive [demokratike] dhe kërkojnë syçeltësi të veçantë dhe një përgjigje efektive nga ana e autoriteteve.” Shiko *Nachova dhe tjerët kundër Bulgarisë*, Gjykata europiane për të drejtat e njeriut, 43577/ 98 dhe 43579/ 98, 26 shkurt 2004, paragrafi 155.

<sup>38</sup> Duhet të kuptohet se këta numra ishin të ndryshëm gjatë veprimtarisë së këtij Operacioni.

<sup>39</sup> Mëse 16 persona nga Operacioni Thor ishin caktuar për t’i futur informacionet në bazën e të dhënave.

<sup>40</sup> Baza e të dhënave ishte shumë vështirë të përdorej në të shumtën e rasteve për shkak të problemeve me njohjen e gjuhës angleze të personave të cilët ofrojnë informata dhe atyre të cilët i fusin ato në bazë të të dhënave, dhe gjithashtu ka pasur edhe probleme se rasti do të kishte shumë versione me theksime të ndryshme, etj.

dyshuarit. Hetuesi i cili kishte udhëhequr hetimet rekomandon që ky rast të mbyllet.” Edhe përkundër kësaj, prokurori komunal me datën 27 qershor 2005 e kishte ngritur propozimkuzën dhe menjëherë me 14 korrik 2005 ishte mbajtur seanca gjyqësore, në të cilën ishte lexuar deklarata e policit e dhënë më 12 prill 2004, ishte shikuar dokumentacioni me fotografi, dhe i akuzuari kishte dhënë deklaratën me të cilën e refuzonte përgjegjësinë penale. Prokurori publik, i cili ishte tjetër nga ai i cili e kishte ngritur padinë, kishte pasur mendimin se nuk kishte dëshmi që i akuzuari kishte kryer vepra penale, dhe gjykata kishte nxjerrë aktgjykimin lirues po të njëjtën datë.

Nuk është e qartë se cilat veprime tjera hetuese i kishin ndërmarrë autoritetet e policisë në mes të prillit 2004 dhe qershorit 2005. Nuk është përmendur asnjë veprim konkret i hetimeve më 6 qershor 2005 në raportin e hetuesisë së policisë.<sup>41</sup> Përkundër faktit se policia në përgjithësi kishte parashikuar mbledhjen e dëshmimeve për ta ndjekur penalisht rastin, nuk mund të përjashtohet se autoritetet hetuese kishin dështuar që ta hetojnë këtë rast me shpejtësinë e kërkuar, së paku sipas veprimeve të standardit për sundimin e ligjit.<sup>42</sup>

Në disa raste, vonesat ishin shkaktuar, jo vetëm për shkak, të sjelljes së policisë, por edhe të autoriteteve gjyqësore dhe organeve tjera që i mbështesin gjykatat.

Në një rast para Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës/Mitrovica, i pandehuri akuzohej për vjedhje të rëndë dhe posedim të paligjshëm të armëve. Në deklaratën e tij para gjyqtarit hetues, dhënë me 24 mars 2004, i pandehuri i kishte pranuar të dy veprat penale dhe është vendosur në paraburgim. I vetmi dëshmitar për këtë rast ishte marrë në pyetje dy muaj pas, më 28 maj 2004. Aktakuza ishte ngritur më 28 korrik 2004, dhe në ditën e ardhshme i akuzuari ishte lëshur pa kusht nga paraburgimi. Seanca për konfirmimin e aktakuzës ishte paraparë që të mbahet më 24 nëntor 2004, katër muaj pas ngritjes së aktakuzës. I akuzuari nuk iu ishte përgjigjur thirrjes për këtë datë, as që ishte përgjigjur thirrjes për datën 2 dhjetor 2004. Duket se gjykata ishte mbështetur vetëm në sistemin e thirrjes me rregull, në vend të përdorimit të mënyrave tjera të mundshme, siç është sjellja e detyrueshme e të akuzuarit para gjykatës.<sup>43</sup> Më 24 janar 2005, i akuzuari ishte paraburgosur për kryerjen e një vepre tjetër penale. Njësitë për transportimin e të burgosurve kishte dështuar që t’a sjellë atë në gjykatë për seancën e konfirmimit e cila ishte caktuar për të tretën herë, për datën 7 shkurt 2005, me arsyetim, se sipas shefit të këtij njësitë, automjetet e tyre nuk janë të përshtatshme që të bëjnë transportimin në rrugë të gjata. Seanca më në fund ishte mbajtur më 9 shkurt 2005, në të cilën i akuzuari ishte deklaruar i fajshëm për të dyja rastet. Edhe pse aktakuza ishte konfirmuar dhe ishte bërë përfundimtare më 11 shkurt 2005, shqyrtimi kryesor ishte mbajtur më 20 qershor 2005, katër muaj më vonë,<sup>44</sup> ku i akuzuari përsëri kishte deklaruar se e pranon fajësinë.

<sup>41</sup> Megjithatë, hetuesi i cili përfundimisht kishte ofruar informatën në raportin e policisë hetimore e kishte informuar edhe OSBE- në se ai e kishte intervistuar të dyshuarin vetë më 4 shkurt 2005, edhe pse nuk kishte kompletuar besueshmërinë në hetimin e bërë më parë.

<sup>42</sup> Shiko *supra* futnotën 37. Më tutje, vlenë të theksohet se një prokuror kishte parashtruar një aktakuzë përmbledhëse duke u bazuar në dëshmi që më parë ishte marrë nga hetuesit e policisë dhe nga prokurori gjatë gjykimit, dhe kjo kishte qenë jo adekuate për të përkrahur ndjekjen penale e këtij të dyshuari. Edhe përkundër faktit se prokurori i parë në fakt kishte mundur që ta parashtronte aktakuzën përmbledhëse në baza të raportit penal [neni 462 (2) KPPPK] kjo me siguri se do të kishte pritur nga prokurori që të jepë mendimin e tij që kjo dëshmi ishte adekuate; dhe nuk ishin siguruar arsyetime të tilla në këtë aktakuzë.

<sup>43</sup> Shiko nenin 270 (1) KPPPK.

<sup>44</sup> Shëno: neni 319 (2) KPPK thekson se “gjyqtari kryesues do të caktoj se kur do të mbahet seanca kryesore menjëherë pasi aktakuza të bëhet përfundimtare. Nëse ai apo ajo dështon që të caktojë se kur do të fillojë të mbahet seanca kryesore në një afat brenda një muaji pasi të bëhet aktakuza përfundimtare, ai ose ajo duhet ta lajmërojë kryetarin e gjykatës për arsyet e kësaj ...”

Edhe përkundër faktit se ky rast nuk kishte qenë i komplikuar, duke pasur pasur parasysh se i akuzuari ishte deklaruar i fajshëm që në fillim të hetimeve, megjithatë përfundimi i procedurës kishte zgjatur një vit e tre muaj.

#### 4. Rekomandimet

- OSBE-ja përsëritë rekomandimet e saja për sa i përket çështjeve për mbrojtjen e dëshmitarit, të cilat janë të paraqitura në rishqyrtimet e mëparshme të sistemit të drejtësisë penale.<sup>45</sup> Në mënyrë më specifike, OSBE rekomandon që:
  - PSSP duhet të lëshojë një urdhëresë administrative që ta fuqizojë obligimin për gjykatat dhe prokurorët që ta informojnë secilin dëshmitar i cili do të mund të jetë nën kërcënim, për masat e disponueshme për mbrojtjen e dëshmitarit.
  - Kodi i përkohshëm penal duhet të ndryshojë, që të thotë në mënyrë shprehimore se është vepër penale shkelja e urdhëresës për masat mbrojtëse.
  - Instituti gjyqësor i Kosovës dhe Oda e avokatëve të Kosovës në bashkëpunim me Qendrën burimore për mbrojtje penale duhet të vazhdojnë me ofrimin e trajnimit për, gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë mbi përdorimin e masave mbrojtëse në procedurë gjyqësore.
  - Policia e UNMIK-ut dhe shtylla e drejtësisë, ta nisin një fushatë publike, që përsëri ta bindin publikun se ekzistojnë masat me të cilat autoritetet mund të mbrojnë dëshmitarët në Kosovë.
  - Organet kompetente duhet që të imponojnë dhe të fuqizojnë sanksione adekuate kundër zyrtarëve publik, avokatëve dhe tjerëve të cilët zbulojnë, si dhe mediave të cilat publikojnë të dhënat konfidenciale sa i përket dëshmitarëve të mbrojtur.
  - Prokurorët dhe autoritetet gjyqësore duhet të hetojnë, ndjekin penalisht dhe dënojnë sulmet ose kërcënimet kundër dëshmitarëve.
  - Udhëheqësit politik duhet të intensifikojnë tentimet e tyre për të nxitur të gjithë kosovarët që të bashkëpunojnë me autoritetet hetuese dhe të gjyqësisë që të zgjidhen krimet, duke përfshirë këtu edhe krimet ndëretnike.
- Krahas masave të parapara me KPPP, ku ka dëshmi se dëshmitarët ishin kërcënuar dhe janë të gatshëm që të rivendosen përbrenda Kosovës apo nodnjë shteti të tretë, autoritetet hetuese, prokuroritë dhe gjyqet duhet që të kërkojnë nga Njësiti për mbrojtje të dëshmitarëve që ta ofrojnë mbrojtjen fizike të dëshmitarit.
- Njësiti për mbrojtje të dëshmitarëve duhet që të sigurojë që dëshmitarëve të mbrojtur t'ju sigurohet mbrojtje e nevojshme para, gjatë dhe pas procedurave gjyqësore.
- Njësiti për mbrojtje të dëshmitarëve dhe/ose policët e SHPK-së të cilët punojnë në gjykatë duhet të sigurojnë që menjëherë pasi dëshmitari të jepë dëshminë e tij/ saj, dëshmitari të përcillet deri te vendi i sigurt dhe se nuk duhet të lihet në vendet publike të ndërtesës së gjykatës.
- OSBE më tutje rekomandon që autoritetet hetuese duhet të ndërmarrin të gjitha masat e domosdoshme për të siguruar deklaratat nga dëshmitarët dhe palët e dëmtuara të cilat nuk mund të jenë në dispozicion për gjykatat për seancën kryesore gjyqësore, dhe atë në formën e cila mund të shfrytëzohet si provë në shqyrtimin kryesor. Veç kësaj, autoritetet prokuroriale duhet të përgatiten që të propozojnë, dhe gjykatat duhet të tentojnë më

<sup>45</sup> Shiko Rishqyrtimi i pestë i OSBE- së i sistemit të drejtësisë penale me titull *Mbrojtja e dëshmitarëve në sistemin e drejtësisë* (mars 2002- prill 2003), f. 26; dhe raportin e gjyshtë me titull *Krimi, paraburgimi dhe dënimi* (dhjetor 2004), f. 77).

seriozisht që t'i sjellin dëshmitarët në Kosovë, që ata personalisht të dëshmojnë, kur konsiderohet se dëshmia ka rëndësi të drejtpërdrejtë për rezultatin përfundimtar të rastit.

- Gjyqtarët dhe prokurorët duhet të parashtrojnë ankesë pranë Njësitit për standarde profesionale për ata policë të cilët nuk paraqiten në gjykatë pa ndonjë arsyetim kur ata të thirren si dëshmitarë.
- OSBE-ja rekomandon që autoritetet gjyqësore të ndërmarrin të gjitha masat e mundshme për të siguruar se rastet shqyrtohen në afat të arsyeshëm kohor.
- Komisioneri i policisë duhet të ndërmarrë të gjithë hapat e duhur për të siguruar se ka një numër i mjaftueshëm i policëve të shpërndarë në tërë Kosovën që janë të trajnuar në veçanti për grumbullimin e dëshmive nëpërmjet video-inçizimeve.

## KAPITULLI TRETË AKUZAT DHE DËNIMET

Ky kapitull mirret me çështjet që kanë të bëjnë me praktikat e ngritjes së akuzave dhe dënimeve të rasteve që ndërlidhen me trazirat. Sekcionet e para dhe të dyta do të përqendrohen në shqetësimet që kanë të bëjnë me akuzat jo adekuate, pranimin e fajësisë dhe deklarimi i fajësisë me marrëveshje. Sekcioni i tretë do të adresojë problemet në praktikat e ndryshme të shqiptimit të dënimeve, disa prej të cilave është raportuar nga OSBE-ja në raportet paraprake,<sup>46</sup> siç janë përdorimi i gabueshëm i rrethanave rënduese dhe lehtësuese si dhe mungesa e ofrimit të arsytimit në rastet e dënimeve të lehta.

### 1. Akuzat joadekuate

Njëri nga problemet e identifikuar në rastet që ndërlidhen me trazirat ishte se, në një numër të konsiderueshëm të aktakuzave, ka pasur mospërputhje në mes sjelljes së të akuzuarit dhe kualifikimit të veprës penale. Në fakt, në disa raste, veprat e përshkruara në aktakuzë që do të mund të kualifikoheshin si vepra penale ose vepra penale të mëdha nuk ishin ndjekur penalisht. Dhe si rezultat, akuzat ishin jo adekuate në dritën e rrethanave të përshkruara në aktakuzën dhe nuk reflektonin përgjegjësinë e prezumuar të të akuzuarit.

Në një rast para Gjykatës së Qarkut në Pejë/Pec, më 5 nëntor 2004 me anën e një aktakuzë i akuzuari ishte akuzuar për kontrollim dhe posedim të paautorizuar të armës.<sup>47</sup> Megjithatë, krahas fakteve që kishin të bënin me këtë akuzë, në vetë aktakuzën ishte theksuar se më 17 mars 2004 i akuzuari ishte identifikuar nëpërmjet video shiritit, “duke folur në një megafon dhe duke bërë një fjalim të shkurtër ku i quante UNMIK-un dhe serbët ‘armiq’ dhe se njerëzit janë në gjendje lufte’ dhe se kishte udhëhequr turmën duke thirrur sllogane.” Aktakuza gjithashtu përmban një referencë se i akuzuari ishte identifikuar nga dëshmitarët se ai kishte qenë prezent në masë afër vendit ku ishin djegur shumë automjete të Kombeve të Bashkuara. Edhe pse këto fakte do të sugjerorin se i akuzuari do të mund të ishte përgjegjës për vepra plotësuese penale,<sup>48</sup> aktakuza nuk kishte përmbajtur akuza tjera dhe ajo ishte konfirmuar më 16 dhjetor 2004 në formën të cilën e kishte patur në fillim.<sup>49</sup> Pamvarsisht nga pjesëmarrja aktive e të akuzuarit në trazirat e marsit, pikat e aktakuzës nuk kishin të bënin me trazirat.

Në një rast tjetër para Gjykatës Komunale në Gjilan/Gnjilane, dy të pandehur ishin akuzuar për shkakim të rrezikimit të përgjithshëm në një vend të tubimeve masive.<sup>50</sup> Në aktakuzën, e ngritur më 7 prill 2004, është theksuar se më 17 mars 2004 të pandehurit kishin shtyer një automjet privat, pronë e një polici serb të Kosovës, jashtë vendparkimit dhe ia kishin thyer të gjithë xhamat, e kishin rrotulluar dhe ia kishin vënë flakën. Më 2 qershor 2004, paneli i përbërë prej tre gjyqtarëve vendor i kishin shpallur të pandehurit fajtorë për krimet e përshkruara në aktakuzë dhe i kishin

<sup>46</sup> Shiko Rishqyrtimi i gjashtë i OSBE- së i sistemit të drejtësisë penale, fusnota e sipërme.

<sup>47</sup> Neni 328 (2) KPP.

<sup>48</sup> Siç janë, pjesëmarrja në turmë e cila kryen veprën penale (neni 320 KPP), pjesëmarrja në një grup i cili i pengon personat zyrtar në kryerjen e detyrave të tyre (neni 318 KPP), dhe nxitja në urrejtje nacionale, raciale, fetare ose etnike, armiqësi dhe jo tolerancë (neni 115 KPP).

<sup>49</sup> Më 8 prill 2005 gjykata e kishte shpallur fajtor të akuzuarin dhe e kishte dënuar me gjobë prej 300 euro. Në mes tjerash, gjykata i kishte konsideruar faktorët vijues si rrethana lehtësuese: “rëndësia e kësaj çështje është shumë e vogël, vepra është e një rëndësie të vogël dhe të rrezikut të vogël, [...] mungesë e pasojave, jo rëndësia e rrethanave në të cilat ishte kryer vepra penale [...]”

<sup>50</sup> Neni 291 (1) dhe (3) KPP, të dënueshme prej gjashtë muaj deri në pesë vite burgim.

dënuar secilin nga ata me nga pesë muaj burgim. Megjithatë, rrethanat e përshkruara faktike, gjithashtu do të caktojnë veprën si krim i dëmtimit të pronës së luajtshme.<sup>51</sup>

Në rastin e tretë para Gjykatës Komunale në Prishtinë/Pristina, gjashtë të pandehur të akuzuar më 23 qershor 2004 për pjesëmarrje në turmën e cila kishte kryer veprë penale,<sup>52</sup> në këtë, nëpërmjet veprimeve të tyre të përbashkëta, ata kishin shkaktuar rrezikim të përgjithshëm dhe kishin dëmtuar pronën në masë të madhe. Sipas aktakuzës, të pandehurit kishin marrë pjesë në protestat e mbajtura në Obiliq/Obilic, ku ishin djegur një numër i shtëpive të serbëve të Kosovës nga ana e protestuesve. Ia vlenë të përmendet edhe ajo se gjatë hetimeve, njëri nga të pandehurit kishte pranuar se ai dhe protestuesit tjerë kishin hedhur gurë, kishin dëmtuar dhe demoluar shtatë deri tetë shtëpi duke menduar se kan qenë të serbëve. Më 28 tetor 2004, i akuzuari ishte shpallur fajtor sipas akuzës.<sup>53</sup>

Përkundër faktit se veprimi i të pandehurve në mënyrë të qartë demonstroi se ekziston elementi i urrejtjes etnike në veprimet e tyre, prokurori vendor nuk i kishte ndjekur penalisht me akuza shtesë ose alternative me vepra penale të nxitjes së urrejtjes etnike ose fetare për shkak të dëmtimit të pronës së personave tjerë.<sup>54</sup> Një shqetësim i ngjajshëm ishte identifikuar në shembullin vijues:

Më 25 janar 2005, prokurori vendor kishte ngritur propozim akuzën në Gjykatën Komunale në Pejë/Pec duke i akuzuar të akuzuarit për pjesëmarrje në grup i cili kishte penguar personat zyrtarë të kryejnë detyrat e tyre.<sup>55</sup> Kjo aktakuzë thekson se më datën 17 mars 2004 i akuzuari iu kishte bashkangjitur grupit i cili lëvizte në drejtim të Bellopoles/Belo Polje dhe më vonë e kishin djegur një pronë e cila i takonte serbëve të Kosovës, si dhe kishin gjuajtur gurë në drejtim të KFOR-it dhe policisë ndërkombëtare. Në këtë rast, veprimet e të akuzuarëve do të paraqisnin veprën penale të nxitjes së urrejtjes etnike ose fetare duke dëmtuar pronën e cila i takon një personi tjetër.<sup>56</sup>

Dhe përveç mos reflektimit të shkallës së përgjegjësisë penale të të pandehurve, akuzat më të lehta kanë rezultuar me dënime më të ulta për secilin rast të veçantë.

## **2. Pranimi i fajësisë dhe deklarimi i fajësisë me marrëveshje**

KPPPK si dhe KPPK kanë dispozita të reja që rregullojnë deklarimin e fajësisë, si në seancën e konfirmimit<sup>57</sup>, ashtu edhe gjatë shqyrtimit kryesor.<sup>58</sup> Pranimi i fajësisë në mënyrë të përgjithësuar është definuar si deklaratë formale me të cilën i pandehuri pranon fajësinë e tij/saj. Sipas ligjit të zbatueshëm në Kosovë, që të jetë një pranim i fajësisë i vlefshëm, duhet të përmbushen një numër kushtesh, gjegjësisht, i pandehuri duhet të kuptojë natyrën e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë duhet të jetë vullnetar dhe duhet të përkrahet nga faktet e rastit dhe dëshmitë e paraqitura nga prokuroria.<sup>59</sup> Paraqitja e pranimit të fajësisë gjithashtu është

<sup>51</sup> Neni 260 KPP. Fakti se automjeti në fjalë i përkiste policit të SHPK- së me përkatësi etnike serbe do të kishte mundur të jetë i rëndësishëm së madhe për akuzën sipas dispozitës së përmendur, nëse ka pasur dëshmi për të sugjeruar anshmëri etnike, pasi neni 260 (2) i KPP e parasheh një dënim më të rëndë në rastet kur dëmet e bëra kanë qenë të motivuara me anshmëri etnik.

<sup>52</sup> Neni 320 (1) KPP.

<sup>53</sup> Katër prej të akuzuarëve ishin dënuar me tetë muaj burgim përderisa dy të tjerët ishin dënuar me nga gjashtë muaj burgim, me kusht për dy vite.

<sup>54</sup> Neni 115 (3) KPP.

<sup>55</sup> Neni 318 (1) KPP.

<sup>56</sup> Shiko *supra* futnota 54.

<sup>57</sup> Nenet 314 dhe 315 KPPP.

<sup>58</sup> Nenet 358 dhe 359 KPPK.

<sup>59</sup> Neni 315 KPPP.



rrethanë lehtësuese që duhet të mirret parasysh nga gjykata kur përcaktojnë dënimet për vepra penale.<sup>60</sup>

Koncept tjetër nga ai i pranimit të fajësisë është koncepti i deklarimit të fajësisë me marrëveshje. I përdorur shpesh si për shembull në Shtetet e Bashkuara të Amerikës deklarimi i fajësisë me marrëveshje mund të definohet si “marrëveshje ndërmjet prokurorisë dhe mbrojtjes si rezultat i të cilit i pandehuri e ndërron deklarin e tij prej i pafajshëm në i fajshëm si shpërblim për një ofertë nga prokurori (për shembull, të mënjanojë akuzat më të mëdha kundër të akuzuarit) ose kur gjyqtari në mënyrë jo formale ka njoftuar se ai do të zvogëlojë dënimin nëse i akuzuari pranon fajësinë.”<sup>61</sup> Dhe ndryshe nga sistemet tjera të drejtësisë,<sup>62</sup> në Kosovë deklarimi i fajësisë me marrëveshje as nuk është i lejuar në mënyrë eksplicite, e as që është i rregulluar me KPPPK. Megjithatë, pavarësisht nga heshtja e ligjit në këtë rast, disa dispozita të veçanta të këtij kodi janë interpretuar nga disa gjyqtarë dhe prokurorë ndërkombëtarë që mirren me rastet e ndërlidhura me trazirat se ato dispozita lejojnë deklarin e fajësisë me marrëveshje.

KPPPK ka futur dispozita të reja që përcaktojnë se gjatë marrjes së aktvendimit për hedhjen ose vërtetimin e aktakuzës dhe marrjen e aktgjykimit, “gjykata nuk obligohet me ndonjë marrëveshje në mes prokurorit publik dhe mbrojtjes sa i përket modifikimit të akuzave ose pranimit të fajësisë.”<sup>63</sup> Këto dispozita janë të dykuptimta sepse përderisa i referohen mundësisë për prokurorinë që të hyn në “marrëveshje” me mbrojtjen, ligji nuk rregullon praktikën e tilla ose nuk ofron ndonjë udhëzim përkitazi me atë se nën cilat kushte do të mund të bëheshin marrëveshjet, kush do të mund të marrë pjesë në negociatën si dhe pasojat e tyre sa i përket të drejtave të palëve të dëmtuara.<sup>64</sup>

Për më tepër, sa i përket ndryshimeve në aktakuzës, KPPPK thotë se “Kur paditësi gjatë shqyrtimit gjyqësor konstaton se provat e shqyrtuara tregojnë se gjendja faktike e paraqitur në

<sup>60</sup> Neni 64 (1) KPP.

<sup>61</sup> Shiko *Oxford Dictionary of Law*, Oxford University Press, botimi i pestë, f. 368.

<sup>62</sup> Shiko, për shembull, neni 231 i KPP i Bosnjës dhe Hercegovinës i cili thekson si në vijim:

“(1) I dyshuari ose i akuzuari si dhe avokati mbrojtës, mund të bëjë negociatën me prokurorin mbi kushtet e pranimit të fajësisë për vepra penale me të cilin i akuzuari ngarkohet penalisht.

(2) Në deklarin e fajësisë me marrëveshje me të dyshuarin ose me të akuzuarin dhe avokatin mbrojtës mbi pranimin e fajësisë sipas paragrafit 1 të këtij neni, prokurori mund të propozojë një dënim të pranueshëm më të ulët se minimumi i përshkruar me ligj për veprat penale ose një dënim më të ulët për të dyshuarin ose të akuzuarin.

(3) marrëveshja për pranimin e fajësisë duhet të bëhet me shkrim. Gjyqtari paraprak i seancës dëgjimore, vetë gjyqtari ose paneli mund të pranojnë ose refuzojnë marrëveshjen në fjalë.

(4) Në kursin e diskutimit për marrëveshje për pranimin e fajësisë, gjykata duhet të sigurojë siç vijon:  
a) marrëveshja e fajësisë është bërë vullnetarisht, me vetëdije dhe me kuptim, dhe se i akuzuari është i informuar për pasojat e mundshme, duke përfshirë edhe kompensimin sipas kundërshtimit nga ligji mbi pronësinë si dhe për kompensimin e shpenzimeve të procedurave penale;

b) se ka dëshmi të mjaftueshme që vërtetojnë fajësinë e të dyshuarit ose të akuzuarit;  
c) se i dyshuari ose i akuzuari e kupton këtë se me marrëveshje për pranimin e fajit ai e fiton të drejtën e tij për gjykim dhe se ai nuk mund të paraqes ankesë kundër sanksionimit të theksuar penal.

(5) Nëse gjykata pranon marrëveshjen për pranimin e fajësisë, deklarata e të akuzuarit duhet të futet në procesverbal. Në këtë rast, gjykata do të caktojë datën për shqiptimin e dënimin të paraparë në marrëveshje që i referohet paragrafit 3 të këtij neni në afat më së shumti deri në tre ditë.

(6) Nëse gjykata e refuzon marrëveshjen e pranimit të fajësisë, gjykata duhet të informojë palët për procedurat si dhe avokatin mbrojtës për refuzimin e të thotë këtë edhe me procesverbal. Pranimi i fajësisë i dhënë para gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i procedurës paraprake dëgjimore, gjyqtarit ose panelit janë të papranueshme si dëshmi në procedurat penale.

(7) Gjykata duhet të informojë palën e dëmtuar për rezultatet e negociatave mbi fajësinë.”

<sup>63</sup> Neni 316 (6) dhe 386 (3) KPPPK.

<sup>64</sup> Neni 315 (2) thekson se “gjatë shqyrtimit të pranimit të fajësisë së të pandehurit, gjyqtari mund të kërkojë pikëpamjet e palës së dëmtuar. Megjithatë, ky nen i referohet pranimit të fajësisë dhe nuk e obligon gjykatësin për të bërë një gjë të tillë. Shiko nenin 359 (3) KPPPK.

aktakuzë është ndryshuar, ai në shqyrtim gjyqësor mund ta ndryshojë aktakuzën gojarisht [...].”<sup>65</sup> Kjo gjuhë duket se sugjeron se qëllim i ligjvënësit ka qenë kufizimi i mundësisë për ndryshim të aktakuzës për situatat në të cilat rrethanat faktike kanë ndryshuar. Kështu, nuk është e qartë se a mundet një aktakuzë të ndryshohet në mënyrë të ligjshme, pas seancës për konfirmim, dhe kjo vetëm për shkak të deklarimit të fajësisë me marrëveshje.

Përkundër dykuptimësisë së ligjit sa i përket pranueshmërisë së deklarimit të fajësisë me marrëveshje, në një numër të rasteve të ndërlidhura me trazirat të monitoruara nga ana e OSBE-së të pandehurit kishin pranuar fajësinë duke iu referuar marrëveshjes me prokurorin ose me trupin gjykues se aktakuza do të ndryshojë dhe/ose do të shqiptohet një dënim më i ulët. Rastet në vijim paraqesin praktikat e tilla:

Një rast para Gjykatës së Qarkut në Prizren përfshin te akuzat për nxitje të urrejtjes nacionale, raciale, fetare ose etnike, armiqësi dhe jo tolerancë,<sup>66</sup> shkaktim të rrezikut të përgjithshëm,<sup>67</sup> dëmtim, demolim dhe zhvendosje të paligjshme të monumenteve të mbrojtura ose objekteve tjera,<sup>68</sup> si dhe pjesëmarrjen në turmën e cila kryente vepra penale.<sup>69</sup> Duke iu referuar një kërkesë nga avokati mbrojtës i njërit nga tre të pandehurit, më 14 dhjetor 2004, ishte bërë një takim jo formal në zyrën e gjyqtarit ndërkombëtar kryesues<sup>70</sup> në të cilin takim ishte arritur marrëveshja për pranim të fajësisë dhe më pas ishte ekzekutuar në seancën gjyqësore. Tre të pandehurit ishin dënuar siç vijon: dy vite e gjysmë burgim me kusht për pesë vite, dhe 22 muaj me burgim me kusht në periudhë prej pesë viteve.<sup>71</sup>

Sipas pikëpamjeve të OSBE-së, pjesëmarrja e dy gjyqtarëve të kolegjit në takimin jo formal gjatë të cilit ishte diskutuar për deklarimin e fajësisë me marrëveshje, nuk është e paraparë me ligjin në fuqi të procedurës penale. Siç është përmendur më sipër, KPPPK vërteton se gjykata nuk obligohet nga ndonjë marrëveshje në mes të prokurorit publik dhe mbrojtjes sa i përket modifikimit të akuzës ose të pranimit të fajësisë, por nuk e rregullon rolin e gjyqtarit gjatë negociatave aktuale të marrëveshjes. Për më tepër, pjesëmarrja e gjyqtarëve në takimet e tilla mund ta minojë paanshmërinë e tyre në rast kur nga ata kërkohet që të shprehin pajtimin e tyre për përmbajtjen e marrëveshjes.

Shembulli i dytë vjen nga Gjykata e Qarkut të Pejës/Pec dhe përfshin një të akuzuar i cili akuzohej fillimisht për pjesëmarrje në grupin që kryen vepra penale,<sup>72</sup> pjesëmarrje si udhëheqës në grupin që pengon personat zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare,<sup>73</sup> pengimin e personit zyrtar në ushtrimin e detyrës zyrtare,<sup>74</sup> dhe nxitje të urrejtjes

<sup>65</sup> Neni 376 (1) KPPP.

<sup>66</sup> Neni 115 (3) KPP.

<sup>67</sup> Neni 291 (1) dhe (5) KPP.

<sup>68</sup> Neni 289 (1) dhe (2) KPP.

<sup>69</sup> Neni 320 (1) KPP.

<sup>70</sup> Pjesëmarrësit në këtë takim ishin gjyqtari kryesues, një gjyqtar porot, prokurori publik si dhe avokati mbrojtës.

<sup>71</sup> Krimet e marra parasysh, ishin për të pandehurin e parë nxitje e urrejtjes nacionale, raciale, fetare ose etnike, armiqësi dhe jo tolerancë (neni 115 (3) KPP), një pikë për shkaktim të rrezikut publik (291 (1) dhe (5) KPP) dhe tjetra për pjesëmarrje në turmë që kishte kryer vepra penale (neni 320 (1) KPP); për të pandehurin e dytë njëra për nxitje e urrejtjes nacionale, raciale, fetare ose etnike, armiqësi dhe jo tolerancë (neni 115 (3) KPP), shkaktim i rrezikut publik (291 (1) dhe (5) KPP) dhe njëra për pjesëmarrje në turmë që kishte kryer vepra penale (neni 320 (1) KPP); dhe për të pandehurin e tretë për nxitje e urrejtjes nacionale, raciale, fetare ose etnike, armiqësi dhe jo tolerancë (neni 115 (3) KPP), njëra ngarkesë i mbajtur përgjegjës për shkaktim të rrezikut publik (291 (1) dhe (5) KPP). Dënimet e zbatuara për krimet në fjalë ndryshojnë prej dënimit me gjobë deri në 12 vite burgim.

<sup>72</sup> Neni 320 (1) KPP, i dënueshëm me burgim prej tre muajve deri në pesë vite.

<sup>73</sup> Neni 318 (2) KPP, i dënueshëm me burgim prej një deri pesë vite.

<sup>74</sup> Neni 316 (3) KPP, i dënueshëm me burgim prej tre muajsh deri në pesë vite.

nacionale, raciale, fetare ose etnike, armiqësi dhe jo tolerancë.<sup>75</sup> Sipas një marrëveshjeje me palën mbrojtëse, sipas të cilës i pandehuri kishte pranuar fajësinë në lidhje me pjesëmarrjen në turmë e cila kishte kryer vepër penale dhe kishin penguar personat zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, prokurori ndërkombëtar kishte ndryshuar aktakuzën gjatë seancës së konfirmimit, e mbajtur më 1 shkurt 2005, që të përfshijë vetëm akuzat për të cilat i pandehuri kishte pranuar fajësinë.<sup>76</sup> Gjatë shqyrtimit kryesor, i pandehuri sërish kishte pranuar fajësinë dhe ishte dënuar me gjashtë muaj burgim nga trupi gjyqësor i përbërë nga një gjyqtar ndërkombëtar (kryesues) dhe dy gjyqtarë vendor porot.

Në këtë rast, si rezultat i këtyre marrëveshjeve, i akuzuari kishte përfituar një trajtim më të favorshëm; aktakuza e ndryshuar, jo vetëm që kishte patur ndikim në dënimin e tij, por edhe, në pajtim me ligjin penal në fuqi, trupi gjykues e kishte konsideruar si rrethanë lehtësuese deklarinin e fajësisë me rastin e caktimit të dënimit<sup>77</sup>.

Në shembullin e tretë, me 1 tetor 2004 nga Gjykata e Qarkut e Pejës/Peć, një i akuzuar ngarkohej për posedim të paligjshëm të armës,<sup>78</sup> për pjesëmarrje si udhëheqës i grupit i cili e ka penguar personin zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare,<sup>79</sup> dhe për falsifikim të dokumenteve.<sup>80</sup> Lidhur me pikën e parë të akuzës, sipas aktakuzës, më 17 mars 2004, i akuzuari dyshohet të ketë përdorur “koktejt Molotovi”, “duke e hedhur mbi gomat të cilat si duket kishin qenë të lagura me përshpejtues të ndezjes, duke shkaktuar kështu shpërthimin e gomave në flakë.” Si rezultat i marrëveshjes së arritur me mbrojtjen, në fillimin e shqyrtimit kryesor, prokurori ndërkombëtar e kishte ndryshuar përshkrimin e veprës penale në aktakuzë, sa vijon: në vend të fjalës “armë” janë përdorur fjalët “mjete të rrezikshme” me qëllim të kualifikimit të “koktejt Molotovi-t”. Me 14 janar 2005, i akuzuari ishte denuar nga trupi gjykues i gjyqtarëve vendës, me një vit heqje lirie për veprën penale të udhëheqjes së grupit i cili i pengon personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare (dënimi minimal i paraparë për këtë vepër penale), dhe me tre muaj burgim për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve.

Është interesant të përmendet se edhe përkundër mungesës së fakteve të reja me të cilat arsyetohet aktakuza, prokurori ndërkombëtar e ka ndryshuar kualifikimin e objektit të përdorur nga i akuzuari. Në të njëjtën kohë, trupi gjykues ka dështuar ta shpjegojë në aktgjykimin e shkruar arsyen se përse “koktejt i Molotovit” nuk definohet si armë në pajtim me KPP. Në fakt, aktgjykimi kryesisht i referohet se “nuk ka vepër penale [posedim i paligjshëm i armës] për shkak se prokurori e ka harruar frazën *vringëllimë e armës* [...]” Si rezultat i ndryshimit të aktakuzës, gjykata ka konsideruar se sjellja e të akuzuarit në lidhje me përdorimin e të përmendurit “objekt i rrezikshëm”, vetëm se është mbuluar me veprën penale të pjesëmarrjes si udhëheqës i grupit i cili i pengon personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare. Mirëpo, për shkak se definicioni i kësaj vepre penale sipas KPP nuk i referohet mjeteve të përdorura gjatë pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrës zyrtare, përfundimi i gjykatës duket të mos jetë i drejtë.<sup>81</sup>

<sup>75</sup> Neni 115 (2) siç lexohet (1) KPP, i dënueshëm me burgim deri në tetë vite.

<sup>76</sup> Gjykata kishte bërë njoftim për këtë marrëveshje në aktgjykimin me shkrim duke thënë “gjykata vëren se [...]si rezultat i pranimit të fajësisë dy nga katër akuzat ishin hedhur poshtë.”

<sup>77</sup> Vlen të përmendet se aktakuza duket se përmban prova të fuqishme të cilat e mbështesin akuzën. Në mesin e provave tjera, prokurori publik ka kërkuar fillimisht shqyrtimin e dëshmimeve të tridhjetë e katër dëshmitarëve, tre filmave video dhe fotografive.

<sup>78</sup> Neni 328(1) KPP.

<sup>79</sup> Neni 318(2) KPP.

<sup>80</sup> Neni 332(3) KPP.

<sup>81</sup> Gjithashtu vlenë të përmendet se përdorimi i mjeteve të rrezikshme nuk është vlerësuar fare nga gjykata si rrethanë rënduese.

Përveç ligjshmërisë së dyshimtë të kësaj praktike, gjithashtu duhet patur parasysh se, së paku në disa raste, arsyet se pse prokuroria ka hyrë në aso marrëveshje kishin të bënin me frikën nga frikësimi i dëshmitarëve dhe për shkak të gjasave të mëdha se dëshmitë e mbledhura gjatë hetimeve nuk do të provoheshin më tutje gjatë gjykimit. Një prokuror ndërkombëtar i kishte thënë OSBE-së se lidhur me shembullin e tretë, të përmendur më sipër, se arsyeja për të hyrë në marrëveshje ishte shmangia e eksponimit të dëshmitarit gjatë gjykimeve publike. Nëse kjo është kështu, shqetësimet janë se për shkak të drojës se dëshmitarët do të frikësohen, atëherë të pandehurit të cilët dyshohen të kenë patur rol aktiv gjatë trazirave, të akuzohen për vepra më të lehta dhe/ose të denohen me dënime më të buta.

### 3. Caktimi i denimeve

#### 3.1 Vrojtimet e përgjithshme –tendenca drejt zbutjes së denimeve

Vlerësimi i reagimit të gjyqësorit ndaj rasteve të ndërlidhura me trazirat nuk do të ishte i plotë pa i analizuar aktgjykimet. Brenda periudhës raportuese, 316 raste janë kryer duke rezultuar me 209 denime dhe 12 lirime. Për 95 raste është hequr dorë nga ndjekja penale. OSBE, ka vërejtur se si zhvillim i përgjithshëm, në shumicën e rasteve të trazirave, dënimet ishin afër minimumit të paraparë me ligj.<sup>82</sup>

Shembujt në vijim, tregojnë për tendencën për zbutje të denimeve për rastet penale kundër rendit dhe qetësisë publike.<sup>83</sup>

Në një rast pranë Gjykatës Komunale të Pejës/Peç, një i akuzuar ngarkohej me veprën penale të pjesëmarrjes në grupin i cili i pengon personat zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare.<sup>84</sup> Sipas propozimkuzës, më 17 mars 2004, i akuzuari kishte marrë pjesë në turmën e cila e kishte bllokuar lëvizjen SPU-ve të Rumanisë në Pejë/Peç, duke i penguar kështu personat zyrtar në kryerjen e detyrave të tyre. Më 15 prill 2005 i akuzuari ishte denuar nga gjyqtari vendës me katër muaj heqje lirie, me kusht për kohëzgjatje prej një viti.

Në shembullin tjetër, nga Gjykata Komunale e Gjilan/Gnjilane, i akuzuari ngarkohej me veprën penale, pjesëmarrje në grupin i cili kryen veprën penale<sup>85</sup> dhe pjesëmarrje në grupin që pengon personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare.<sup>86</sup> Në aktakuzë përshkruhet mënyra se si më 17 mars 2004, i akuzuari kishte marr pjesë në turmën e cila kishte hyrë në tokën e kishës me qëllim që ta ndezin atë, para se të ndaloheshin nga KFOR-i dhe SHPK-ja. Në aktakuzë më tej përmendet se i akuzuari gjithashtu kishte hyrë në oborrin e shtëpisë të një serbi të Kosovës dhe u kishte shkaktuar lëndime të rënda trupore dy serbëve të Kosovës. Më 28 qershor 2004, kolegji i përbërë nga tre gjyqtarë vendës e kanë shpallur fajtor të akuzuarin dhe denuar me gjithsejt gjashtë muaj burgim: katër muaj për pjesëmarrjen e tij në grupin që kryen

<sup>82</sup> Për shembull, në shumicën e rasteve të cilat përfshijnë akuzat për pjesëmarrje në grupin që pengon personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare (neni 318(1) KPP, veprë e cila bart dënimin me gjobë dhe burgim deri në tri vjet, dënimet ishin në mes të tri dhe gjashtë muajsh burg zakonisht me kusht për kohëzgjatje prej një viti. Më tutje, në një numër rastesh në të cilat të pandehurit akuzoheshin për pjesëmarrje në grupin që kryen veprën penale (neni 320(1) KPP, që bart dënimin me burg prej tre muaj deri në pesë vjet), ky dënim sillej prej katër muaj deri në një vit burgim, dhe në shumicën e rasteve jepet me kusht për periudhë prej një deri në dy vjet.

<sup>83</sup> Kreu XXVIII i KPPP.

<sup>84</sup> Neni 318(1) KPP, me gjobë dhe burgim deri në tri vjet.

<sup>85</sup> Neni 320(1) KPP.

<sup>86</sup> Neni 318(1) KPP.

vepër penale dhe tre muaj në lidhje me pjesëmarrjen e tij në grupin që pengon personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare.<sup>87</sup>

Tendenca për denime më të lehta gjithashtu është vërejtur në rastet e trazirave të cilat ndërlidhen edhe me veprat tjera penale. Shembulli në vijim manifeston të njëtin rezultat në lidhje me rastet e vjedhjes.

Rasti ishte para Gjykatës Komunale të Prizrenit, dhe përfshinte dy të akuzuar fillimisht me dy pika të akuzës për vjedhje të rëndë.<sup>88</sup> Më 2 qershor 2004, dy të akuzuarit ishin dënuar nga trupi gjykues vendor me nga gjashtë muaj burgim secili.<sup>89</sup> Më 26 korrik 2004, prokurori ndërkombëtar kishte ushtruar ankesë kundër këtij vendimi. Në mesin e arsyeve tjera, prokurori ndërkombëtar argumentonte se kualifikimi i veprës ishte i gabuar duke patur parasysh faktet e rastit dhe se minimumi i denimit prej gjashtë muajsh ishte tepër i ultë dhe nuk e pasqyronte peshën e krimit.<sup>90</sup>

Denimet e buta për një numër të konsiderueshëm rastesh, deri në një masë, mund të shpjegohen me dështimin e gjykatave të marrin parasysh rrethanat rënduese për rastet e trazirave. Kjo çështje do të trajtohet në nënpjesën e mëposhtme të këtij raporti.

### **3.2 Rrethanat rënduese dhe lehtësuese të shqyrtuara nga gjykatat**

#### *3.2.1 Rrethanat rënduese*

Sipas ligjit penal në fuqi, gjatë përcaktimit të dënimit për veprën e caktuar penale, gjykata i merr parasysh të gjitha rrethanat relevante të cilat janë rënduese ose lehtësuese për dënimin e paraparë.<sup>91</sup> Megjithëse ligji përcakton një numër rrethanash të cilat duhet pasur parasysh si të rëndësishme, kjo listë nuk është përfundimtare dhe gjykatat kanë për obligim që të shqyrtojnë edhe rrethanat tjera nëse ato konsiderohen si të rëndësishme për caktimin e dënimit.<sup>92</sup> Motivi i veprës penale, shkalla e rrezikshmërisë ose e dëmtimit të vlerës së mbrojtur dhe rrethanat nën

<sup>87</sup> Vepra e parë denohej me burgim prej tre deri në pesë vjet dhe e fundit me burgim deri në tri vjet.

<sup>88</sup> Neni 253(1) pikat 1 dhe 3 të KPP-së. Gjatë shqyrtimit kryesor, të mbajtur me 1 janar 2004, aktakuza ishte ndryshuar dhe prokurori e kishte zbutur akuzën nga vjedhja e rëndë në vjedhje (neni 252(1) KPP). Ndryshimi është bërë pa ndonjë arsyetim të dhënë për këtë qëllim.

<sup>89</sup> Prokurori publik e kishte hudhur njërin nga akuzat lidhur me njërin nga të akuzuarit gjersa i akuzuari tjetër ishte liruar nga njëra pikë e akuzës për vjedhje.

<sup>90</sup> Gjykata Komunale e kishte refuzuar këtë ankesë mbi bazat se ishte ngritur pas afatit prej tetë ditëve sipas nenit 400(1) dhe (2) KPPP. Sipas mendimit të OSBE-së, bazat e paraqitura nga gjykata për refuzimin e ankesës nuk janë në pajtim me ligjin në fuqi. Në fakt, neni 400(2) i KPPP-së në mënyrë shprehimore përcakton se, përveç në rastet nga paragrafi 4 i të njëjtës dispozitë, respektivisht në rastet kur i akuzuari është dënuar me burgim, “[k]ur personi me të drejtë ankese nuk e paralajmëron ankesën brenda afatit të paraparë ligjor, konsiderohet se ai ka hequr dorë nga e drejta në ankesë, përveç në rastin nga paragrafi 4 i këtij neni.” Për shkak se në rastin konkret të dy të akuzuarit ishin dënuar me burgim, afati prej tetë ditësh për paralajmërimin e ankesës nuk është dashur të zbatohet.

<sup>91</sup> Neni 64(1) KPP.

<sup>92</sup> Në lidhje me dispozitën e ngjajshme të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, shih, dr. Franjo Baqiq, Ljubo Bavcon, Miroslav Gjorgjeviq, Bozhidar Kraus, Lubisha Llazareviq, Momir Lutovac, Nikola Srzentiq dhe Aleksandar Stajiq, *Komentarin e Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ)*, (Beograd, Savremena Administracija, 1978), për nenin 41(1) LPJ, ku në mënyrë specifike përmendet se “[g]jatë shqyrtimit të rrethanave rënduese dhe lehtësuese duhet patur parasysh se çdo rrethanë konkrete, rënduese dhe lehtësuese, mund të vlerësohet drejtë vetëm e ndërlidhur me të gjitha rrethanat tjera që janë të rëndësishme për vlerësimin e dënimit. Shqyrtimi i izoluar i rrethanave konkrete lehtësuese dhe rënduese nuk e jepë pasqyrën reale të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale [...]” [përkthim jozyrtar].

të cilat është kryer vepra penale me ligj konsiderohen se kanë rëndësi të veçantë për matjen e dënimit.<sup>93</sup>

Një prej trendeve të vërejtura në lidhje me rastet e trazirave ishte se, shumë prej denimeve nuk i kanë marr parasysh rrethanat rënduese. Në lidhje me rastet e trazirave të marsit 2004, disa rrethana rënduese kanë mundur të jenë se motivi për kryerjen e veprës penale ka qenë fyerja e personit ose e grupit etnik për shkak të përkatësisë etnike,<sup>94</sup> përdorimi i armëve, mënyra e rrezikshme e kryerjes së veprës penale, ose se akti ishte kryer kundër policisë.<sup>95</sup> Në fakt, disa prej këtyre fakteve rënduese mund të përbëjnë edhe vepra të ndara penale.

Lidhur me rrethanat rënduese që janë marr parasysh për rastet individuale, një nga shqetësimet e vërejtura nga OSBE ishte se, në rastet e caktuara, gjykatat nuk e kanë vlerësuar ndonjë nga faktorët rëndues.

Në së paku tri rastet e shqyrtuara nga Gjykata Komunale e Prizrenit me akuza për pjesëmarrje në grupin që kryen vepër penale,<sup>96</sup> të akuzuarit paditëshin për pjesëmarrje në grupin i cili më 18 mars 2004 i kishte sulmuar dhe lënduar 25 oficer të SHPK-së dhe gjashtë policë ndërkombëtar dhe i kishin shkatërruar 19 automjete të Kombeve të Bashkuara dhe dy automjete të SHPK-së në Prizren. Në aktgjykimet e shkruara nuk ishin theksuar fare faktorët rëndues. Në këto raste, sikur caku i veprës penale ashtu edhe intenziteti i rrezikshmërisë do të përbënin rrethanë rënduese.

Në një rast para Gjykatës Komunale të Prishtinës/Priştina më 28 tetor 2004, gjashtë të akuzuar u shpallën fajtor për pjesëmarrje në grupin që kryen vepër penale.<sup>97</sup> Në raport me secilin të akuzuar, shprehimisht theksohet në aktgjykim se “gjykata nuk ka gjetur asnjë rrethanë rënduese specifike”(përkthimi jozyrtar). Mirëpo, akuzat nga ky rast i referohen pjesëmarrjes në grupin i cili e ka djegur një numër shtëpish të serbëve të Kosovës në Obiliq/Obilić. Fakti se caku i veprës penale ishin personat që i përkisnin grupit të pakicës etnike nuk ishte vlerësuar nga gjykata si rrethana rënduese.

Në rastet tjera, jo vetëm që ka dështuar gjykata që t’i vlerësojë rrethanat rënduese, por rrethanat e vlerësuara vetëm se ishin elemente të veprës penale në fjalë.

Në rastin e shqyrtuar nga Gjykata Komunale e Pejës/Peć, një i akuzuar ngarkohej me pjesëmarrje në grupin që pengon personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare.<sup>98</sup> Sipas propozimkuzës, më 17 mars 2004, i akuzuari ka marrë pjesë në turmën e cila në atë ditë e kishte bllokuar rrugën në Pejë/Peć dhe për këtë arsye i ka penguar oficerët e policisë ndërkombëtare të njësitit special në kryerjen e detyrave të tyre. I akuzuari ishte deklaruar i fajshëm gjatë gjykimit dhe kishte marrë dënimin prej katër muaj burgim, me kusht për një vit. E vetmja rrethanë rënduese që ishte marr parasysh

<sup>93</sup> Shih nenin 64(1) KPP.

<sup>94</sup> Shih, vendimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për rastin *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë, fusnota e sipërme 37*, paragrafi 158, ku gjykata deklaroi se “trajtimi i dhunës dhe brutalitetit të motivuar nga shkaqet racore në mënyrë të njëjtë me rastet të cilat nuk janë të natyrës raciste do të ishte e njëjtë sikur të mbyllet sytë para akteve të natyrës specifike të cilat i dëmtojnë në veçanti të drejtat fundamentale [...]”.

<sup>95</sup> Për veprat penale që burojnë nga trazirat, jurisdikcionet tjera i kanë balansuar faktorët rëndues dhe lehtësues të zbatuar në rastet konkrete, me rrethanat *kollektive* rënduese që ndërlidhen me kontekstin në të cilën janë kryer veprat penale, siç është, shkalla e dhunës së shprehur, numri i personave të angazhuar, kohëzgjatja dhe objekti i dhunës, shkalla e prishjes së rendit dhe qetësisë publike dhe nevoja për vetpërmbytje. Shih raportin e Bredfordit, fusnota e mësipërm 33, pp. 40-47.

<sup>96</sup> Neni 320 KPP.

<sup>97</sup> Neni 320(1) KPP. Katër të akuzuar ishin denuar me tetë muaj burgim ndërsa, dy ishin denuar me gjashtë muaj burgim, me kusht për dy vjet.

<sup>98</sup> Neni 318(1) KPP.

nga gjykata ishte fakti se i akuzuri nuk kishte shfaqë respekt për personat zyrtar, për të cilën gjë me ligj ishte i obliguar. Mirëpo, kjo rrethanë rënduese është pjesë e përkufizimit të veprës penale. Në fakt, akti i pengimit të personave zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare e përfshinë edhe mosrespektimin e shfaqur kundrejt autoriteteve policore dhe për këtë shkak, gjykata nuk ishte dashur ta konsiderojë si rrethanë rënduese.

Në njërin nga rastet e monitoruara nga OSBE, gjykata e ka marrë si rrethanë lehtësuese mungesën e dosjes penale për të akuzuarin, edhe pse në të vërtetë, i akuzuari ka qenë më heret i denuar.<sup>99</sup>

Në rastin para Gjykatës Komunale të Gjilanit/Gnjilane, i akuzuari ishte shpallur fajtor më 2 qershor 2004 për sulmin e drejtuar ndaj personave zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare dhe kishte marrë dënimin me burgim në kohëzgjatje prej tre muajsh<sup>100</sup>. Një rrethanë lehtësuese që ishte marrë parasysh ishte fakti se i akuzuari nuk kishte qenë më heret i akuzuar. Mirëpo, OSBE-ja e ka monitoruar një rast tjetër me të njëjtin të akuzuar i cili në fakt ishte denuar nga Gjykata e Qarkut e Gjilanit/Gnjilane me 10 mars 2003 për armëmbajtje pa leje,<sup>101</sup> me dënim prej një viti dhe gjashtë muaj burgim me kusht për katër vite. Për këtë arsye, jo vetëm që më heret ky i akuzuar ishte i denuar, por në muajin mars 2004 ai gjindej në kohën provuese të kushtit nga dënimi i mëhershëm.<sup>102</sup>

Në këtë shembull, gjykata ka dështuar të sigurojë informatat e sakta lidhur me dosjen penale të të akuzuarit.<sup>103</sup> Rrjedhimisht, fakti i cili do të duhej vlerësuar si rrethanë rënduese, në vend të kësaj ishte konsideruar si lehtësuese.

Vërejtjet e OSBE-së se edhe pse këto të dhëna mund të bëhen të ditura vetëm pas përfundimit të procedurës së provave, KPPP përcakton se “Kur i akuzuari pranon fajësinë, të gjitha informatat lidhur me dënimet e mëparshme të të akuzuarit lexohen para se palët të paraqesin fjalën përfundimtare.”<sup>104</sup> Kjo dispozitë sugjeron që, pas momentit të paraqitjes së provave, lënda duhet të përmbajë të dhënat nga evidenca e të denuarve lidhur me dosjen penale të të akuzuarit.

### 3.2.2 Rrethanat lehtësuese

---

<sup>99</sup> OSBE nuk është në dijeni se ekziston një institucion në Kosovë ku të dhënat mbahen në nivelin qendror. Sipas nenit 296 të Ligjit për rregullat e brendshme të veprimtarisë së gjykatave (*Gazeta zyrtare e KSA të Kosovës*, nr. 7/81), duhet të ketë në secilën gjykatë komunale dhe të qarkut një libër në të cilën regjistrohen të gjitha “lëndët penale të gjykatave komunale dhe të qarkut të shkallës së parë për fajësinë e personave madhor”. Mirëpo, duket se secila gjykatë e ka vetëm librin e vet, në të cilin regjistrohen aktgjykimet vetanake. Kjo nënkupton se aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan/Gnjilane nuk shihet në evidencën e aktgjykimeve të Gjykatës Komunale të Pejës/Peç.

<sup>100</sup> Neni 317(2) KPP.

<sup>101</sup> Neni 199(3) dhe (1) në vështrim të nenit 22 KPK, i lexuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/7, nenet 8.2 dhe 8.6.

<sup>102</sup> OSBE është në dijeni se sa i përket dënimit të pare, gjatë procedurës i akuzuari i ka dhënë gjykatës mbiemrin e gabuar. Megjithatë, procesverbali gjyqësor duhet të përmbajë informata të sakta mbi të dhënat personale për kryesit e veprave penale që përfshin jo vetëm emrin e kryesit por edhe informata të tjera siq janë datëlindja e tij/sa, emrat e mbiemrat e prindërve të tij/saj, vendbanimi, profesioni e tjera. Shiko futnotëm më poshtë 103 dhe Nenin 218 RFJ LPP.

<sup>103</sup> Sipas KPP, dosja penale përmbanë “të dhënat personale mbi kryerësin e veprës penale, informacioni mbi dënimin, vërejtja e gjykatës, masa e trajtimit të detyrueshëm ose lirimi i kryerësit nga dënimi i shqiptuar, ndryshimet në informacionin mbi dënimet që janë futur në dosjen penale dhe informacioni mbi dënimet e mbajtura si dhe mbi shlyerjen e dënimeve të gabueshme,” neni 89(1) KPP.

<sup>104</sup> Neni 375 KPPP. Gjithashtu neni 354(2) KPPP.

Nënpjesa e tanishme merret me rrethanat specifike lehtësuese që janë vlerësuar gabimisht nga gjykatat.<sup>105</sup>

Në mesin e rasteve të trazirave të kryera brenda periudhës raportuese, 35 të akuzuar janë deklaruar të fajshëm. Përgjithësisht dhe në pajtim me ligjin penal në fuqi,<sup>106</sup> gjykatat e konsiderojnë deklarin e fajësisë si rrethanë lehtësuese. Mirëpo, nga gjykatat nuk i jepej rëndësi momentit të deklarin të fajësisë në përgjithësi<sup>107</sup>. Rrjedhimisht, nuk bëhej dallim ndërmjet rasteve në të cilat të akuzuarit e deklaronin fajësinë që në fillim të procedurës dhe rasteve tjera ku të akuzuarit e deklaronin fajësinë gjatë gjykimit.

OSBE ka identifikuar edhe jokonsistencë përkitazi me rëndësinë që i jepet natyrës së deklarin nga i pandehuri për rastet të cilat burojnë nga rrethanat e njëjta faktike. Në rastet e përshkruara më poshtë, një i akuzuar i cili ishte deklaruar i fajshëm ishte denuar me masë më të rëndë ndëshkimore se sa të pandehurit tjerë të cilët ishin deklaruar të pafajshëm për të njëjtat vepra.

Në një numër rastesh të ndryshme penale para Gjykatës Komunale në Prizren, të pandehurit akuzoheshin për pjesëmarrje në grupin që kryen vepër penale.<sup>108</sup> Të pandehurit kishin marrë pjesë në grupin i cili e ka sulmuar stacionin regjional të policisë së UNMIK-ut, duke me rezultuar me 25 oficerë të SHPK-së dhe gjashtë oficerë ndërkombëtar të lënduar sidhe dy automjete private të dëmtuara. Më 23 shkurt 2005, i vetmi i akuzuar i cili ishte deklaruar i pafajshëm kishte marrë denimin prej gjashtë muajve burgim, me kusht për dy vjet, ndërsa denimet për të akuzuarit që ishin deklaruar të fajshëm, silleshin prej minimumit prej tetë muajve deri në maksimumin prej një viti.<sup>109</sup>

Marrja e disa fakteve të parëndësishme si rrethana lehtësuese ishte edhe një nga mangësitë e gjetura në disa prej aktgjykimeve.

Në një rast pranë Gjykatës Komunale në Prizren, dy persona ishin denuar më 2 qershor 2004 me gjashtë muaj burgim, secili për vjedhje të dy këmbanave dhe një mbajtese qirinjesh nga një kishë. Një nga faktorët të cilin gjykata e kishte konsideruar si rrethanë lehtësuese ishte fakti se krimi ishte kryer pa ndonjë agjendë politike.

Siç është raportuar më heret nga OSBE-ja,<sup>110</sup> megjithëse agjenda politike mund të përbëjë rrethanë rënduese, mungesa megjithatë nuk do të duhej konsideruar si faktor lehtësues kur vepra penale në fjalë është vjedhja.

Përdorimi joadekuat i rrethanave lehtësuese ka rezultuar në jokonsistencë të caktimit të denimeve për rastet e trazirave si dhe në denime më të buta si rezultat i vlerësimit të gabuar të faktorëve lehtësues.

---

<sup>105</sup> OSBE më heret ka raportuar për këtë çështje në Shqyrtimin e gjashtë të sistemit të drejtësisë penale, *supra* fusnota 14, pp. 43-46. Problemet e përshkruara në shqyrtim me këtë rast janë ripërsëritur në raport me rastet e trazirave.

<sup>106</sup> Neni 64(1) KPP.

<sup>107</sup> Në vendet tjera, momenti i deklarin të fajësisë konsiderohet jashtëzakonisht i rëndësishëm. Shih raportin e Bredfortit, *supra* fusnota 33, ku thuhet: “Brenda secilës kategori të deklarin të fajësisë, të pandehurit të cilët e kanë bërë këtë qysh heret në fillim të procedurës ata krahasimisht kishin përparësi ndaj atyre të cilët ishin përcaktuar që deklarin e fajësisë ta shtyenin deri atëherë kur mund ta shihnin ngjyrën e syve të anëtarëve të jurisë (porotës).” p. 41.

<sup>108</sup> Neni 320(1) KPP.

<sup>109</sup> Këto dënime jepeshin me kusht për periudhat kohore prej një deri në dy vite.

<sup>110</sup> Misioni i OSBE-së në Kosovë – Shqyrtim i gjashtë të sistemit të drejtësisë penale, *supra* fusnota 14, p. 44.



### 3.2.3 Arsyetimi i pamjaftueshëm i dënimit të zbutur

Një shqetësim tjetër lidhur me aktgjykimet është se në një numër rastesh, denimet ishin nën minimumin e përcaktuar me ligj, pa ndonjë rrethanë lehtësuese konkrete të paraqitur në aktgjykim në formën e arsytimit.<sup>111</sup> Ky problem është vërejtur në një seri rastesh të trazirave. Në disa prej shembujve të paraqitur mëposhtë, aktgjykimet e shkruara i referoheshin përgjithësisht rrethanave të përgjithshme lehtësuese si arsytetime për denimin e dhënë më të butë se minimumi i përcaktuar me ligj. Megjithatë, gjykatat nuk e kishin sqaruar se cilët faktorë konkret janë marrë si rrethana të jashtëzakonshme lehtësuese dhe nuk i kishin dhënë arsytet se përse të njëjtat konsiderohen të rëndësishme për këto raste.<sup>112</sup>

Në një rast pranë Gjykatës Komunale të Gjilanit/Gnjilane, më 2 qershor 2004, i akuzuari ishte dënuar nga trupi gjykues vendor me tre muaj burgim për shkak të sulmit drejt personave zyrtar që kryejnë detyrat zyrtare,<sup>113</sup> vepër kjo e cila bartë dënimin prej gjashtë muajsh. Në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës, thuhet se “sipas nenit 66 të KPP, gjykata konstaton se ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme lehtësuese dhe se qëllimi i ndëshkimit mund të arrihet edhe me dënim më të butë” (përkthim jozyrtar). Nuk janë theksuar rrethanat konkrete në aktgjykim për ta arsytuar dënimin e shqiptuar nën kufirin e përcaktuar me ligj.

Në shembullin e dytë para Gjykatës Komunale të Gjilanit/Gnjilane, më 23 prill 2004, të akuzuarit i ishte shqiptuar dënimi me tre muaj burgim, për shkak të shkakimit të rrezikut të përgjithshëm,<sup>114</sup> ku dënimi më i vogël i lejuar është gjashtë muaj burgim.<sup>115</sup> Në këtë rast, përveç mosdhënjes së arsytimit për dënimin më të lehtë, gjykata kishte dështuar edhe të përmend se dënimi i shqiptuar nuk ishte në pajtim me normën në fuqi për minimumin e dënimit.

Shembulli i tretë vjen nga Gjykata Komunale e Kamenicës/Kamenica. Më 8 korrik 2004, i akuzuari ishte shpallur fajtor dhe dënuar me katër muaj burgim për shkak të sulmit ndaj personave zyrtar që kryejnë detyrat zyrtare.<sup>116</sup> Prap, në këtë shembull gjykata nuk e kishte përmendur ndonjë rrethanë të veçantë lehtësuese e cila e arsyeton shqiptimin e dënimit më të lehtë se atë të paraparë me ligj. Në fakt, gjykata as që e ka bërë fare të ditur se dënimi ishte përjashtimisht më i lehtë. Gjithashtu vlenë të përmendet se edhe gjatë shqyrtimit të rrethanave rënduese se i akuzuari kishte qenë

---

<sup>111</sup> Neni 66(2) i KPP mundëson caktimin e dënimit më të vogël se kufiri i caktuar me ligj “kur gjykata gjenë se ekzistojnë rrethana veçanërisht lehtësuese të cilat vërtetojnë se qëllimi i ndëshkimit mund të arrihet edhe me shqiptimin e dënimit më të ultë.” Krahas kësaj, neni 396(8) i KPPP, përcakton se “Kur i akuzuari dënohet me burgim, arsyetimi përfshin rrethanat të cilat gjykata i ka marrë parasysh me rastin e caktimit të dënimit. Gjykata veçanërisht arsyeton se në cilat shkaqe është bazuar kur ka konstatuar se është e nevojshme të shqiptojë dënim më të butë ose ta heqë dënimin.” Gjithashtu shih Branko Petriq, *Komentarin e Ligjit të procedurës penale* (Beograd, vëllim i dytë, Gazeta zyrtare e RSFJ, 1986) për nenin 357 paragrafin VII(2) në të cilin thuhet se “[zbatimi i dispozitave adekuate për ndryshimin e dënimit (neni 42 dhe 43 i KP të RSFJsë) [...] duhet veçanërisht dhe përmbajtësisht të arsyetohet [...]].”

<sup>112</sup> Gjithashtu shih nenet 402 dhe 403 KPPP të cilat korrespondojnë me nenet 363 dhe 364(1) të LPP të RFJ si ligj i mëhershëm në fuqi.

<sup>113</sup> Neni 317(2) KPP.

<sup>114</sup> Neni 291(3) i ndërlidhur me (1) KPP.

<sup>115</sup> I akuzuari ishte dënuar me tre muaj burgim edhe për sulmin ndaj personave zyrtar që kryejnë detyrat zyrtare, në lidhje me nenin 317 (1) KPPK. Dënim i shqiptuar për dy vepra penale ishte pesë muaj burgim.

<sup>116</sup> Neni 317 (2) KPP, i dënueshëm me pesë muaj deri në pesë vjet.

më heret i dënuar,<sup>117</sup> gjykata nuk e ka sqaruar përse fakti se i akuzuari ishte recidivist nuk ishte marrë si pengesë për dënimin përjashtimisht të lehtësuar.<sup>118</sup>

Mungesa e arsytimit të duhur të vendimeve gjyqësore për lëndët në të cilat është shqiptuar dënimi i zbutur, jo vetëm që paraqet shkelje të ligjit në fuqi por edhe nuk i shërben qëllimit të dënimit në raport me secilin të akuzuar. Për më tepër, kjo praktikë gjithashtu mund të ndikojë në perceptimin e opinionit publik mbi atë se si i përgjigjet sistemi gjyqësor veprave penale kundër rendit dhe qetësisë publike.

#### 4. Rekomandimet

- Gjykata Supreme duhet ta jepë mendimin<sup>119</sup> me të cilin sqarohet nëse marrëveshja për fajësinë lejohet me kodin e procedurës penale në fuqi dhe nëse po, nën cilat rrethana dhe kush duhet të merr pjesën këto marrëveshje.
- Në vendimet mbi ankesat, Gjykata Supreme duhet të theksojë se aktykimet dhe vendimet lidhur me dënimet të nxjerra nga gjykatat më të ulëta duhet të përmbajnë arsytimin adekuat veçanërisht kur vendoset për dënim të zbutur.
- Instituti Gjyqësor i Kosovës dhe të ofrojë trajnime të mëtutjshme për prokurorët dhe gjykatësit për çështjet e shqiptimit të dënimeve, duke nënvizuar nevojën për arsytim të hollësishëm dhe konkret, si dhe përdorim të drejtë të rrethanave lehtësuese dhe rënduese.
- Instituti Gjyqësor i Kosovës duhet të vazhdojë me trajnimet për prokurorë publik dhe gjyqtarë në lidhje me zbatimin e njëtrajtshëm të aktit të deklarimit të fajësisë.
- Njësia e inspektionit gjyqësor duhet t'i hetojë rastet në të cilat nuk janë dhënë arsytime të duhura për dënimet e shqiptuara nën minimumin e përcaktuar me ligj.
- Para caktimit të dënimit për veprën penale të kryer, gjyqtarët duhet të sigurojnë të dhëna të sakta, nga të gjitha gjykatat, lidhur me dosjen penale të personit të akuzuar.
- Kodi i përkohshëm i procedurës penale duhet të ndryshojë dhe shprehimisht të theksojë se pas paraqitjes së provave gjatë gjyqimit, kryetari i trupit gjykues duhet të kërkojë nga autoritetet kompetente të dhënat më të reja, në lidhje me dosjen penale të të akuzuarit. Këto të dhëna duhet të futen në shkresat e lëndës gjyqësore.
- Departamenti i UNMIK-ut për drejtësinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Shërbimeve Publike (Departamenti i administratës gjyqësore), dhe komunitetin e donatorëve duhet të sigurojnë krijimin e një baze të të dhënave me informata të sakta për të gjithë popullatën e Kosovës, lidhur me dosjet e tyre penale, dhe këto informata t'u vëhen në disponim gjykatave sipas kërkesës së tyre.

---

<sup>117</sup> I akuzuari më heret kishte qenë i dënuar për vjedhje të rëndë (neni 135 KPP) dhe pjesëmarrje në grupin që pengon personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare (neni 185 KPP).

<sup>118</sup> Neni 64(2) i KPP shpallë rrethanat të cilave duhet kushtuar vëmendjen gjatë caktimit të dënimit për recidivistët, një nga të cilat është që ai/ajo më heret e ka kryer veprën e të njëjtit lloj.

<sup>119</sup> Shih nenin 31(7) të Ligjit për gjykatat e rregullta.

## KAPITULLI I KATËRT

### PËRFUNDIM

Mospërputhja midis numrit të pjesëmarrësve në ngjarjet e dhunshme të marsit 2004 në një anë, dhe në anën tjetër, të numrit të personave të cilët janë ballafaquar me procedura penale, si rezultat i veprave penale të kryera gjatë trazirave, tregon se me akuza janë ballafaquar vetëm një përqindje e vogël e personave të përfshirë në to.

Nga 316 rastet e kryera deri më tani, mund të përfundohet se organet hetimore dhe ato gjyqësore nuk janë marrë me këto raste, me aq zellshmëri sa është kërkuar. Vështirësitë për mbledhjen e provave për shkak të zhvendosjes të palëve të dëmtuara dhe problemi i rishfaqur i frikësimit të dëshmitarëve, janë pjesë e shpjegimit të vonësve procedurale si dhe numrit të vogël të dënimeve.

Së fundi, duke vendosur dënime më të buta për shumicën e rasteve të ndërlidhura me trazirat, gjykatat kanë dështuar në dërgimin e mesazhit të qartë për dënimin e sjelljeve të tilla, dhe si duket nuk i kanë konsideruar veprat penale të cilat kanë rrjedhur nga trazirat e Marsit 2004 si aq serioze. Ky reagim relativisht i dobët i gjykatave ndaj veprave penale të kryera gjatë trazirave të marsit 2004, jo vetëm që i kontribon përshtypjes së mosndëshkueshmërisë në popull për këtë lloj krimesh me motive etnike, por edhe mund të konsiderohet si reagim joadekuat për parandalimin e akteve të ngjajshme të çrregullimeve publike në të ardhmen.

## ANEKSET

### ANEKSI 1. PASQYRA STATISTIKORE PËR RASTET E TRAZIRAVE

18 nëntor 2005

Në përgjithësi

Gjykatat	Numri i personave të akuzuar	Rastet e papërfunduara	Rastet e tërheqjes së akuzave	Dënimet	Lirimet
Gjykatat e qarkut	46	7	5	32	2
Gjykatat komunale	238	90	55	84	9
Gjykatat kundërvajtëse	142	13	35	93	1
<b>Gjithsejt:</b>	<b>426</b>	<b>110</b>	<b>95</b>	<b>209</b>	<b>12</b>

Rajoni i Prishtinës/Priština

Gjykatat	Numri i personave të akuzuar	Rastet e papërfunduara	Rastet e tërheqjes së akuzave	Dënimet	Lirimet
Gjykatat e qarkut	11	3	2	5	1
Gjykatat komunale	72	30	13	28	1
Gjykatat kundërvajtëse	12	2	1	9	–
<b>Gjithsejt:</b>	<b>95</b>	<b>35</b>	<b>16</b>	<b>42</b>	<b>2</b>

Rajoni i Gjilanit/Gnjilane

Gjykatat	Numri i personave të akuzuar	Rastet e papërfunduara	Rastet e tërheqjes së akuzave	Dënimet	Lirimet
Gjykatat e qarkut	9	1	1	7	–
Gjykatat komunale	56	13	8	28	7
Gjykatat kundërvajtëse	48	5	26	16	1
<b>Gjithsejt:</b>	<b>113</b>	<b>19</b>	<b>35</b>	<b>51</b>	<b>8</b>

### Rajoni i Prizrenit

Gjykatat	Numri i personave të akuzuar	Rastet e papërfunduara	Rastet e tërheqjes së akuzave	Dënimet	Lirimet
Gjykatat e qarkut	16	1	–	14	1
Gjykatat komunale	25	11	–	14	–
Gjykatat kundërvajtëse	82	6	8	68	–
<b>Gjithsejt:</b>	<b>123</b>	<b>18</b>	<b>8</b>	<b>96</b>	<b>1</b>

### Rajoni i Pejë/Peç

Gjykatat	Numri i personave të akuzuar	Rastet e papërfunduara	Rastet e tërheqjes së akuzave	Dënimet	Lirimet
Gjykatat e qarkut	4	–	1	3	–
Gjykatat komunale	69	23	34	12	-
Gjykatat kundërvajtëse	–	–	–	–	–
<b>Gjithsejt:</b>	<b>73</b>	<b>23</b>	<b>35</b>	<b>15</b>	

### Rajoni i Mitrovicës/Mitrovica

Gjykatat	Numri i personave të akuzuar	Rastet e papërfunduara	Rastet e tërheqjes së akuzave	Dënimet	Lirimet
Gjykatat e qarkut	6	2	1	3	–
Gjykatat komunale	16	13	–	2	1
Gjykatat kundërvajtëse	–	–	–	–	–
<b>Gjithsejt:</b>	<b>22</b>	<b>15</b>	<b>1</b>	<b>5</b>	<b>1</b>